



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV**

Nr. Prot. 855

Tiranë, 27/07/2018

Lënda: Dërgohet Raportimi i Veprimtarisë Vjetore të Autoritetit
të Aviacionit Civil për vitin 2017

Zotit Damian Gjiknuri
Ministër
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

I nderuar Zoti Ministër,

Duke ju falenderuar për mbështetjen Tuaj të vazhdueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil, më lejoni t’ju informoj se në zbatim të Nenit 20, të Ligjit nr. 10233 datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” i ndryshuar, Raportimi nga Autoriteti pika 1e tij, Autoriteti i Aviacionit Civil ka hartuar një raport mbi:

- Veprimtarinë vjetore të tij, përfshirë vendimet e marra nga Këshilli Drejtues;
- Pasqyrën financiare vjetore;
- Realizimin e planit të ardhurave e të shpenzimeve;
- Të dhënrat mbi licencat e lëshuara, regjistrat, miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj.

Gjithashtu vlen të veçohen në këtë raport se për periudhën 2017 kanë konsistuar problematikat si më poshtë:

- Në aspekte të rëndësishme të administrimit të shërbimit civil, AAC nuk i ka zbatuar detyrimet ligjore, që i ngarkon ligji nr. 152/2013 “ Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Ndër të tjera, ajo çka vlen të theksohet, është fakti se, megjithëse DAP ka konstatuar pavlevshmërinë absolute, për një numër të konsiderueshëm të akteve të emërimit, përsëri në institucion ka vazhduar e njëjtë situatë në kundërshtim me ligjin.


- Mosmiratimi i planeve të punës mbi objektivat e vitit 2017, nga drejtuesi i institucionit.
- Si rrjedhojë nuk mund të monitorohej performanca e punës së çdo drejtorie përgjatë vitit.
- Mos funksionimi i sistemit të brëndshëm të cilësisë, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirsim dhe marrjen e masave parandaluese, si mungese e fokusit te drejtuesit të institucionit.
- Mos zbatimi i Reg EC 261/2004 e transpozuar me Udhëzimin e Ministrit Nr. 1, datë 26.02.2013, “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anullimit ose vonesës gjatë fluturimeve”.
- Subjektivizëm për sa i përket dhënies së lejeve të fluturimit për avionët dhe helikopterët.

Në përfundim dua të garantoj se për vitin 2018 janë marrë masat e nevojshme, për zbatimin e ligjshmërisë në institucion.

- Ristrukturimi i AAC është bërë konform ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Janë larguar të gjithë punonjësit që ishin me akte absolutisht të pavlevshme.
- Janë përcaktuar objektivat e vitit sipas formate të reja, dhe janë bërë më të matshme. Problematikat e vitit paraardhës janë zërtyher në objektiva me afate të përcaktuara dhe persona përgjegjës, në zbatim të së cilës do të monitorohet performanca e secilit prej nëpunësve.
- Eshtë në proces marrja e një konsulenti ekspert në fushën e menaxhimit të cilësisë, i cili do të ndihmojë AAC, për hartimin dhe certifikimin me ISO 9001:2015, me qëllim rritjen, përmirsimin e veprimtarisë dhe cilësisë së punës në përputhje me standartet ndërkombëtare.
- Ka nisur ndërgjegjësimi i fushatës për mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve “E drejta nuk vonon, AAC avokati juaj”. Prezencë dhe komunikim me pasagjerët në TIA, riprodhimin i udhëzuesve informativ dhe tabelave informuese, në mbrotje të të drejtave të cënuara.

- Asistencë direkte në plotësimin e formularëve të ankimimit. Ndjekje e rasteve deri në mbyllje të plotë të procedurës në komunikim shkresor dhe elektronik me kompanitë ajrore.

Me respekt,



Krislen Keri



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL**



**RAPORTI I VEPRIMTARISË VJETORE
2017**

Shkurttime: (Sipas Aplikimeve)

AAC	- Autoriteti Aviacionit Civil
DMAA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aerodromeve dhe Aeroporteve
DASHM	- Drejtoria e Administrates dhe Shërbimeve Mbështetëse
DKCSMS	- Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë
DMSHLA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror
DMSA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion
DAMO	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Oper. Ajror dhe Org. të Miratuara të Mirëmbajtjes
DST	- Drejtoria e Standardizimit Teknik
DE	- Drejtoria Ekonomike
EASA	- Agjencia Evropiane e Sigurisë në Aviacion
EC	- Komisioni Evropian
ECCAIRS	- Qëndra e Koordinimit Evropian Sistemit Raportimit të Incidenteve në Aviacion
IANS	- Instituti i Shërbimeve të Navigimit Ajror
ICAO	- Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
LSSIP	- Implementimi Rajonal i Qiellit të Përbashkët
RAT	- Risk Assesment Tools
SAAQ	- Pyetësori Shtetëror i Aktivitetit të Aviacionit
SAFA	- Vlerësimi i Sigurisë për Avionët e Huaj
SSP	- Programi Shtetëror i Sigurisë

ECAA/ ZPEA- Marrëveshje shumëpalëshe ndërmjet vendeve evropiane rrith një tregu të vetëm.

Tabela e Përbajtjes

1. PËRMBLEDHJE	4
1.1 MISIONI	4
1.2 VIZIONI	4
1.3 STRATEGJIA	5
1.4 ORGANIGRAMA	6
1.5 FUNKSIONET	7
1.6 KËSHILLI DREJTUES	8
1.7 DREJTORI EKZEKUTIV	10
2. OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2017	11
3. ARRITJET PËR PERIUDHËN	13
4. PROBLEMATIKAT PËR PERIUDHËN	13
5. PROGRESI I PUNËS PËR PERIUDHEN SIPAS FUSHAVE PËRKATËSE	14
6. STATISTIKAT	37

PËRMBLEDHJE

1.1 MISIONI

Misioni i Autoritetit të Aviacionit Civil është të krijojmë një mjeshtëri me standarde ndërkontinentale, përmes monitorimit të vazhdueshëm, ndërveprimit me operatorët dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit të AAC.

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar ka përgjegjësi të qartë për rregullimin dhe mbikqyrjen e parrezikshmërisë dhe sigurisë në të gjithë veprimtarinë e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit Nr. 10.040 datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Duke qenë anëtare në Organizatat Ndërkontinentale të Aviacionit, në përputhje me detyrimet përkatëse, ne jemi plotësisht të përkushtuar "për të garantuar rritle të sigurt dhe të rregullt të aviacionit ndërkontinentar civil në nivel global". Objektivat tona për nxitjen e sigurisë integrohen me sistemet e ICAOs/ ECAC, / EASAs dhe EUROCONTROL, të traspozuara në legjislacionin bazë të aviacionit civil në R.SH, Kodit Ajror, Ligjet për Autoritetin e AAC si dhe VKM-ve, Urdhrade, Udhëzimeve të dalë me qëllim, garantimin e një transporti ajror të sigurtë.

AAC është e orjentuar drejt përbushjes me efektivitet dhe eficencë të nevojave të pasagjerëve dhe shoqërisë në terreni. AAC kërkon të promovoje zhvillimin e aviacionit civil dhe të thjeshtëzojë zhvillimin ekonomik në të gjithë vendin, nëpërmjet mbështetjes dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me të gjithë palët e përfshira.

1.2 VIZIONI

Vizioni i Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar është që të ketë në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme siguri dhe eficencë në bazën e aktivitetit të tij, duke u bërë kështu plotësisht i përputhshëm me rrjetin evropian të transportit ajror.


Një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit tonë është garantiimi i burimeve të mjaftueshme financiare në mënyrë që personeli të ketë aftësitë e duhura dhe trajnimet për përbushjen e përgjegjësive të tyre, si në lidhje me sigurinë apo funksione të tjera. AAC-ja përpinqet të nxisë konceptet dhe parimet e menaxhimit të parrezikshmërisë dhe sigurisë, si edhe të edukojë ofruesit e operatorët e shërbimit të aviacionit me këto koncepte.

1.3 STRATEGJIA

Strategjia mbi të cilën do të mbështetet përmbushja e qëllimit të autoritetit dhe përpjekjet për të arritur vizonin tonë bazohet në:

- Punësimin e personelit me kualifikime të larta, në pajtim me kërkesat e ICAO-s dhe BE-së/EASA
- Trajnimin sistematik të personelit të ri dhe ekzistues për të garantuar ekspertizën e mjaftueshme për çdo funksion të AAC-së;
- Vendosjen e një Sistemi Menaxhimi, themeli i të cilit do të jetë baza operative e Autoritetit. Produkti i këtij sistemi do të jetë kontributi në arritjen e përmbushjes së objektivave në autoritet;
- Bashkëpunimi me Autoritetet e tjera me qëllim harmonizimin dhe standardizimin e procedurave.
- Marrjen e masave të vazhdueshme nga Menaxhimi i Lartë për të garantuar parrezikshmérinë dhe sigurinë.
- Sigurimi i mbikqyrjes së vazhdueshme të operatorëve nëpërmjet auditimeve, inspektimeve si dhe vëzhgimeve të njoftuara e të panjoftuara.
- Rritja e të ardhurave të AAC-së, si dhe menaxhimi eficient i tyre, duke realizuar investimet në funksion të përmirsimt të veprimtarisë së punës.

1.4 ORGANIGRAMA e AAC sipas VKM nr. 100 datë 26/02/2014



Shenim: Për vitin 2017 me Vendimin nr.60 të KD dhe miratimin e Ministrat, struktura e AAC është shtuar me një nr. punonjësish 6 veta- në njesinë kabinet, numri total i strukturës së AAC shkon 72.

Me Vendimin nr. 69 të KD dhe miratimin e Ministrat, struktura e AAC u shtua me një nr. Punonjësish 11 veta, numri total i strukturës shkoi 83.

1.5 FUNKSIONET

Aktivitetet e Autoritetit lidhen kryesisht me veprimet rregullatore dhe proceduriale për të siguruar parrezikshmërinë ajrore (safety) dhe arritur nivele të pranueshme të sigurisë për të gjithë aktoret e palët e përfshira të Aviacionit Civil të R.SH.

Aktivitetet kryesore të autoritetit përfshijnë por nuk kufizohen në:

- licencimin dhe çertifikimin e transportuesve ajror;
- licencimin dhe çertifikimin e avionëve, përfshirë inspektimet e nevojshme të kushteve teknike dhe operacionale të avionit;
- administrimin e regjistrat të avionëve civilë dhe të çdo regjistri tjetër të aviacionit civil;
- licencimin dhe klasifikimin e pilotëve, të anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit dhe personelit tjetër të aviacionit, që duhet licencuar ne zbatim te Kodit Ajror, përfshirë licencimin e instruktorëve të fluturimit për këtë personel;
- licencimin e personelit të shërbimit të lundrimit ajror (SHLA);
- licencimin e inspektorëve të aviacionit;
- licencimin e kontrolluesve të shëndetësisë;
- çertifikimin dhe licencimin e aerodromeve;
- mbledhjen e informacionit për personelin e aviacionit dhe avionët, si dhe për shpërndarjen e tyre;
- mbledhjen dhe analizimin e raporteve dhe të dokumenteve të tjera për teknologjinë e aviacionit, operimin e avionëve dhe personelin e aviacionit, deri në atë masë që kjo ndihmon, për zbatimin e funksioneve, në përputhje me Kodin Ajror
- auditimin e kushteve teknike dhe operuese, si dhe të fuqisë ekonomike të sipërmarrjeve të aviacionit dhe sistemeve trajnuese të aviacionit;
- bashkërendimin, çertifikimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë së transportit ajror
- përzgjedhjen, çertifikimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror;

- ➔ organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore në bashkëpunim me autoritetet ushtarake;
- ➔ funksione të tjera të parashikuara në këtë Kod dhe në aktet e tjera, të dala në zbatim të tij.

1.6 KËSHILLI DREJTUES

Veprimitaria e AAC-së, në zbatim të ligjit për Autoritetin e Aviacionit Civil, ndihmohet nga Këshilli Drejtues, i cili është organi vendimarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit. KD i AAC-së përbëhet nga pesë anëtarë.

Këshilli Drejtues në zbatim të Ligjit Nr. 10233, datë 11/02/2010, i ndryshuar ka këto kompetenca:

- ➔ Miraton programet e zhvillimit të Autoritetit, në përputhje me strategjinë e aviacionit civil;
- ➔ Propozon te Ministri strukturën organizative të Autoritetit dhe strukturën e pagave që do zbatohen;
- ➔ Miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorive, sektorëve, nëpunësve dhe punonjësve të tjerë;
- ➔ Miraton programin finanziar të Autoritetit dhe ndryshimet e tij, për të cilën informon ministrin, si dhe mbikëqyr realizimin e tij;
- ➔ Propozon te ministri masën e tarifave që do të zbatohen nga Autoriteti, sipas pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, për shërbimet që kryen, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët te ministrit që mbulon çështjet e transportit dhe Ministrat të Financave;
- ➔ Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjisacionit në fuqi.

Për vitin 2017 Këshilli Drejtues i AAC-së ka marrë vendime për çeshtje të transferimit të kapitalit apo të lidhura me buxhetin, strukturen e AAC-së, konkretisht si më poshtë:

1	Vendimi Nr.65, datë: 26/01/2017 “ Për disa ndryshime në rregulloren e pagave”.
2	Vendimi Nr.66, datë: 23/02/2017 “Për disa ndryshime në organikën e Aeroportit të Kukësit”.
3	Vendimi Nr.67, datë: 23/02/2017 “ Për transferim kapitali pranë MTI (kompjuter copë 9”
4	Vendimi Nr.68, datë: 23/02/2017 “Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren e brëndshme të KD”
5	Vendimi Nr.69, datë:12/04/2017 “Organika e AAC shtohet me disa pozicione”
6	Vendimi Nr.70, datë: 12/04/2017 “Disa ndryshime në strukturën organizative të AAC”
7	Vendimi Nr.71, datë: 31/05/2017 “Për kalim kapitali”
8	Vendimi Nr.72, datë:31/05/2017 “ Për stafin e AAC dhe aeroportit të Kukësit”
9	Vendimi Nr.73, datë: 31/05/2017 “ Ndryshim në programin e 2017 të AAC”
10	Vendimi Nr.74, datë: 31/05/2017 “ Ndryshim në vlerën e fondit rezervë të AAC-së”
11	Vendimi Nr.75, datë: 24/07/2017 “Mbi vlerësimin e punonjësve të AAC për performancën 6 mujore”
12	Vendimi Nr.76, datë: 24/07/2017 “Për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për punonjësit e Aeroportit të Kukësit”
13	Vendimi Nr.77, datë: 31/10/2017 “Rialokimi fondit përkthim”

14	Vendimi Nr.78, datë: 21/12/2017 “Emërimi i sekretares së bordit”
15	Vendimi Nr.79, datë: 21/12/2017 “ Miratimi i Strukturës Organizative të AAC-së”
16	Vendimi Nr.80, datë: 21/12/2017 “Miratimi i buxhetit 2018 të AAC”

1.7 DREJTORI EKZEKUTIV

Gjatë vitit 2017 Drejtori Ekzekutiv ka marrë masa për drejtimin e Autoritetit në përbushje të kërkesave të Ligjit Nr. 10233 datë 11.02.2010 “Për AAC-në” i ndryshuar. Veprimet përblidhen, por nuk kufizohen, si më poshtë:

- Janë dhënë urdhra për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit, në zbatim të disiplinës së punës dhe respektimit të kodit etik;
- Janë nxjerrë urdhra për shpërblimin mbi performancën për punonjësit;
- Janë paraqitur pranë Këshillit Drejtues propozime për ndryshime në strukturë, rialokim fondesh, ndryshim në programin ekonomik etj.
- Janë ngritur grupe pune për inspektime të operatoreve;
- Kanë dalë urdhra për ngritjen e grupit të punës së AAC-së për SSP;
- Janë realizuar miratime të licencave sipas kategorive përkatëse;
- Janë nxjerrë urdhra për pritje përcjellje të delegacioneve të huaja;
- Janë nxjerrë urdhra të brëndshëm për prokurimin e objekteve të parashikuara në regjistrin e parashikimeve për vitin 2017;
- Jane marrë vendime mbi miratimin e procedurave, manualeve të brëndshme të autoritetit me qëllim permirësimin e punës në AAC;
- Ka mbajtur kontakte ndër institucionet publike, sipas nevojës, veçanërisht me MTI, nëpërmjet raportimeve e informimeve të vazhdueshme;

2. OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2017

Objektivat të AAC për vitin 2017 nuk janë miratuar por për shkak të specifikave të institucionit, kryesisht konsistojnë si më poshtë:

- Detyra licencuese/çertifikuese dhe aprovime/miratime të operatoreve të Aviacionit Civil
 - Çertifikimi/ Liçencimi i operatorëve
 - Çertifikimi/Liçencimi i stafit të operatorëve
- Detyra mbikëqyrëse të Operatoreve të Aviacionit Civil
 - Faza përgatitore për kryerjen e inspektimeve/auditimeve
 - Ndjekja e planeve të inspektimit pranë operatorëve
 - Ndjekja e gjetjeve të rezultuara nga inspektime/auditime të operatorëve
- Detyra rregullatore në funksion të standartizimit të rregullore në fushën e trasportit ajror të cilat rrjedhin në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe veçanërisht atyre europiane. Hartimi, monitorimi dhe përshtatja e rregulloreve, procedurave të brëndshme dhe të jashtme në përputhje me standardet e ICAO-s dhe rregulloreve të BE.

Përveç këtyre funksioneve kryesore, AAC angazhohet gjithashtu në:

- Koordinimin me Organizatat Ndërkombëtare të ICAO, EASA, EUROCONTROL, ECAC, në kuadër të përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e RSH me këto organizata;
- Zbatimi i Planeve Korriguese të rezultuara nga detyrat e lëna nga vizitat e Organizatave Ndërkombëtare;
- Koordinimi me strukturat si Policia e Shtetit, Dogana Shqiptare, Forcat Ajrore, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme me qëllim rritjen e masave dhe garantimin e sigurisë në aviacion
- Koordinim me Autoritetet e vëndeve fqinje, veçanërisht AAC Kosovës;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore të AAC në funksion të kryerjes së detyrave përkatëse me qëllim përbushjen e standardeve për ruajtjen dhe rritjen e cilësisë në Aviacionin Civil;
- Aplikimim i FUA në hapësirën e RSH

- ↳ Adresimi i gjetjeve të EASA-s
- ↳ Përmirësimi i efektivitetit të aktiviteteve të monitorimit të përputhshmërisë dhe metodologjisë së përdorur.
- ↳ Rritja e frekuencës së aktiviteteve të monitorimit të përputhshmërisë ndaj aeroporteve, operatorëve të avionit, operatorëve të tjera dhe OSHLA që të plotësojnë dispozitat e PKSAC .
- ↳ Raportime të brëndshme dhe planifikime;
- ↳ Zbatimin e strategjisë dhe politikave ekonomike-financiare të Autoritetit, të përcaktuara nga strukturat drejtuese, Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv;
- ↳ Pajisjen me kredenciale për inspektoret e AAC-së;
- ↳ Në bashkëpunim me TIA-n dhe Albcontrol evidenton vonesat dhe anullimet e fluturimeve të shoqërive ajrore që operojnë në Republikën e Shqipërisë, duke bërë raporte mujore, 3 mujore dhe 6 mujore për Drejtorin e DZHTA, ku shihet dhe zbatimi i të drejtave të pasagjerëve për çdo rast.
- ↳ Mbikëqyrjen e vazhdueshme të qëndrueshmërisë të nivelit ekonomiko-financiar të fondeve, me qëllim, në përputhje edhe me marrëveshjet ndërkombëtare, legjislacionin kombëtar e udhëzues specifik, mbulimin financier për nevojat strategjike në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të Autoritetit;
- ↳ Mbështetjen e drejtorive operacionale dhe teknike në përbushjen e detyrave funksionale;
- ↳ Garantimi i shpërndarjes së fondeve sipas nevojave të drejtorive;
- ↳ Garantimi i kushteve për ushtrimin normal të veprimtarisë së Autoritetit;
- ↳ Përfaqesimi ligjor i AAC-së në të gjitha nivelet e gjykimit;
- ↳ Realizimi i procesit të prokurimit, me qëllim realizimin në kohë dhe në mënyrë eficente të planit financier.

Për sa me sipër, Operatorët e Aviacionit Civil Shqiptar për periudhën në fjalë ishin:

- Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” (TIA)
- OSHLA- ALBCONTROL sh.a
- Kompania Albawings

3. ARRITJET PËR PERIUDHËN

Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur arritje të konsiderueshme në fushën e parrezikshmërisë dhe sigurisë, por janë realizuar:

- Bashkëpunimi dhe asistimi me përfaqësuesen e EASAs Znj. Hazel Courteney; Projektit EASA IPA 3 në fushën e hartimit të SSP;
- Raportimi dhe mbledhja e të dhënava statistikore në sistemin ECCAIRs për regjistrimin e ngjarjeve të ndodhura;
- Koordinime me Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës për fusha të ndryshme të veprimtarisë;
- Ushtrimi i funksioneve rregulluese dhe të mbikqyrjes tek ofruesit e shërbimeve navigacionale dhe thellimin e bashkëpunimit me strukturat e tjera shtetërore (nëpërmjet CAA\NSA), dhe me ato ndërkontaktare në fushën që përfshin navigimin ajror.
- Avancime në kuadrin ligor dhe rregulator me referencë standardet ndërkontaktare;
- Unifikimi dhe përshtatja e të dhënave statistikore për 2017.

4. PROBLEMATIKAT PËR PERIUDHËN

- Në aspekte të rëndësishme të administrimit të shërbimit civil, AAC nuk i ka zbatuar detyrimet ligjore, që i ngarkon ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij. Ndër të tjera, ajo çka vlen të theksohet, është fakti se, megjithëse DAP ka konstatuar pavlevshmërinë absolute, për një numër të konsiderueshëm të akteve të emërimit, përsëri në institucion ka vazhduar e njëjta situatë në kundërshtim me ligjin.
- Mosmiratimi i planeve të punës mbi objektivat e vitit 2017, nga drejtuesi i institucionit. Si rrjedhojë nuk mund të monitorohet performanca e punës së çdo drejtorie përgjatë vitit.
- Mos funksionimi i sistemit të brëndshëm të cilësisë, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirsim dhe marrjen e masave parandaluese, si mungese e fokusit te drejtuesit të institucionit.
- Mos zbatimi i Reg EC 261/2004 e transpozuar me Udhëzimin e Ministrit Nr. 1, datë 26.02.2013, “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anullimit ose vonesës gjatë fluturimeve”.

- Subjektivizëm për sa i përket dhënies së lejeve të fluturimit për avionët dhe helikopterët.
- Problematikë mbetet kompletimi me specialistë të fushave teknike me njohuri dhe eksperiençë në aviacionin civil shqiptar;
- Nevoja e një Biznes Plani Strategjik afat gjatë të AAC ka bërë që veprimtaria e saj të mos jetë e rakorduar në aspektin kombëtar përfshirë tu fokusuar në objektivat Pan-European dhe atyre kombëtare sidomos kur këto lidhen me institucione të tjera në vend ose organizma ndërkombëtare (në proces);
- Mungesa e një Rregulloreje të Brëndshme të përditësuar me ndryshimet ligjore dhe funksionale për institucionin;
- Mos miratimi i Aneksit 19 dhe ndryshimeve të Kodit Ajror (në të cilin është përfshirë një Nen për SSP-në), të cilët janë dy faktorë kyç përvazhdimin e procesit të SSP-së;
- Mos miratimi i Kodit Ajror të përmirësuar i cili është edhe gjetje e EASAs;
- Adoptimi i shpeshtë i legjislacionit vendas me atë të EU, si dhe fakti që Shqipëria nuk është EU Member, e vështirëson aplikimin dhe harmonizimin në aspektin kohor të rregullave dhe kërkesave të EU;
- Mos aplikimi i sanksioneve ndaj operatorëve, në mungesë të parashikimeve në Kodin Ajror;
- Gjatë realizimit të objektivave përvitit 2017 mbetet problematike çështja e përkthimit nga shqipja në anglisht dhe anasjelltas e dokumentacionit ashtu siç është kërkuar nga vlerësuesit e komisionit evropian.

5. PROGRESI I PUNËS PËR PERIUDHEN SIPAS FUSHAVE PËRKATËSE

Më poshtë është paraqitur një tablo e përbledhur e veprimtarisë kryesore sipas fushave përvitit 2017.

5.1 Çështje të Parrezikshmërisë (safety) në fluturim për operatorët ajror

Në kryerjen e detyrave të saj funksionale dhe institucionale, AAC-ja promovon zhvillimin e Aviacionit Civil duke garantuar sigurinë në fluturim, përputhjen me standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s po ashtu dhe Rregulloret dhe Direktivat e BE-së si dhe kërkesave të tjera të lidhura me çështjet e Operimeve, Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes, si dhe të Ekuipazhit Ajror dhe Organizatave përkatëse.

Ndërsa aktivitetet kryesore të kësaj drejtoria përvitit 2017 mund të përmendim:

- Riçertifikimi i avionit ultralight "ZA-EDE". (Sokol Çunaj)

- Miratimi i dokumentacionit të nevojshëm për kompaninë Shega Air, në kuadrin e aplikimit të saj për marrjen e AOC.
- Rishikimi i vlefshmërisë ajrore për helikopterin “ZA-KEI”, të Shega Air.
- Rishikimi i vlefshmërisë ajrore për avionin An-2 me regjistrim “ZA-DEA”, të Shega Air.
- Regjistrimi dhe çregjistrimi i avionit ZA-ABB të kompanisë “Albanian Airways”.
- Ne kuadrin e aplikimit të bërë nga Kompania Ajrore “Albanian Airways” për marrjen e AOC, me letrën datë 31/03/2017 nr. prot.1 bëri kërkesën për të regjistruar avionin A320-212 me numër serie 409, të cilin me letrën datë 24/07/2017 me nr. prot. 23 e zëvendësoi me avionin e të njëjtë tip A320-212 me Nr. Serie 427. Mbi këtë bazë, sektori i vlefshmërisë ajrore dhe mirëmbajtjes filloi punën për regjistrimin e këtij avioni.
- Mbas shqyrtimit te dokumentacionit të kërkuar, si dhe ardhjes e inspektimit të avionit në dt 24/09/2017, avioni u regjistraua në datën 04/10/2017 me shenjën e regjistrimit ZA-ABB.
- Me regjistrimin e avionit, duhet të fillonte procesi i çertifikimit të tij, duke i lëshuar çertifikatën e vlefshmërisë ajrore dhe çertifikatën e rishikimit të vlefshmërisë ajrore, të cilat nuk u lëshuan nga Drejtori Ekzekutiv për faktin se ato ishin të lidhura dhe me lëshimin e çertifikatës së operatorit ajror (COA), e cila ishte në proces.
- Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga Albanian Airways për marrjen e COA, Autoriteti i Aviacionit Civil doli në përfundim se Albanian Airways nuk plotësonte kushtet për pajisjen me Çertifikatë të Operatorit Ajror dhe si rrjedhoje, me letrën nr. prot. 68 datë 26/12/2017 Albanian Airways kërkoi heqjen nga regjistri Aeronautik Shqiptar të avionit, i cili u çregjistraua në datë 28/12/201
- Lëshimi i licencave të specialisteve të mirëmbajtjes së Avionëve.
- Në zbatim të planit vjetor të auditimeve u kryen auditet:
 - Në Organizatën e mirëmbajtjes “Magnetic MRO”,
 - Në Organizatën e menaxhimit të vlefshmërisë ajrore “Magnetic MRO”,
 - Në Organizatën e mirëmbajtjes së linjës “Blue Panorama” në Tiranë,
 - Inspektimi/auditimi i bazës së mirëmbajtjes të miratuar sipas Pjesës 145 i “Helicopters Albania” me çertifikate AL.145.001, si dhe Organizata e Menaxhimit të Vijueshmërisë së Vlefshmërisë Ajrore miratuar sipas Pjesës M me çertifikatë AL.MG.001.
 - Në Organizatën e Mirëmbajtjes sipas Pjesës 145 dhe Organizatën e Menaxhimit të Vijueshmërisë së Vlefshmërisë ajrore (CAMO) të “Helicopters Albania” në datë 13.12.2017.

- Në Organizatën e Menaxhimit të vijueshmërisë së vlefshmërisë ajrore (CAMO) për "Albwings" në datë 20.12.2017.
- Në sistemin e Manaxhimit te Sigurisë në fluturim të Organizatës Albawings në datë 05.10.2017 (në bashkëpunim me sektorin e operimeve ajrore)

Lëshimin, Validimin, Rivalidimin e Licensave të Ekuipazhit Ajror

- Shqyrtim Dokumentacioni dhe lëshimi i ***Licenses se Pilotit Privat (PPL H), Shkurt 2017 Sokol Çunaj***
- Shqyrtim Dokumentacioni dhe dhënie e vlefshmërisë ***Licensës së 2 Pilotëve Privat (PPL H) Eduard Koci, Altin Lama, 8 Maj 2017.***
- Shqyrtim Dokumentacioni dhe lëshimi i ***Licensave të pilotit privat (Paragajd) për 8 pilotë, Prill 2017***

Alket Islami, Arion Vreto, Anisa Lera, Blerina Braç, Xhonatan Islami, Ilir Davidhi, Siljanm Zani, Sidrit Deda.

AVIONET KOMERCIAL PËR TRANSPORT PUBLIK

Data e regjistrimit Nº. Registration date	Emri i firmës prodhuese Producer's name	Data e prodhimit Product ion date	Tipi Type	Nr. Serise Serial number	Kompania pronare Owner company	Shenja e regjistrimit Registration stamp	Data e heqjes nga regjistrimi Removal date	Inspektor i Marresi i çertifikatës Receiver of certificate	Nr. I certifikates Certificate number	Vendim gjykate Court Decision	Shënim Notes
1.	23/3/2016	BOEING	1990	B 737-500	24972	Albawin ZA-AWA	DAMO	Gentjan Kole	573		
2.	04.10.2017	AIRBUS	1994	A 320-212	0427	Airways ZA-ABB 7	28.12.2017	DAMO	Skender Loli	28	Gregjistimi u bë me kërkesë të pronarit me
3.	26.01.2018	BOEING	1989	B 737-400	24352	Albawin ZA-AEB		DAMO	Gentjan Kole	574	

AVIONE PRIVATE DHE KOMERCIAL JO PER TRANSPORT PUBLIK

Nr No.	Kodi Code	Data e regjistrimit Registratio n date	Emri i firmes prodhuese Producer's name	Tipi Type	Nr. Serial number	Komp ania pronar mit	Sherja e Regjistri ngat	Data e heqjes nga	Inspektorji i regjistrit Registra tion Oëner compa ny	Martesia i Certifica tes of Receiver Inspector sign	Nr. i Vendim giykat Court Decision Certifica te number	Sheni me Notes
1	LATI	27.05.2015	Augusta westian	A109- AII	7258	Shega Air	ZA-KEI		DAMO	Ervin Shijaku	6873	
2	LATI	21/10/15	Cessna 550	Citation	550- 0060	SHega Air	Z.A-AMA		DAMO	Ervin Shijaku	313	
3	LATI	07/12/15	Sociata TB-10	1989	AERO SP	935	Agim Muçaj	Z.A-AGM	DAMO	Agim Muçaj	16	
4	LATI	22/06/16	ZENAIR	2011	STOL CH-701	7-8503	Z.A- EDF		DAMO	Endri Cunaj	2787	
5	LATI	21/01/16	ESK "PZL MIELEK" Poland An-2	1974	An-2	1G156- 29	ZA-DEA Shega Air		DAMO	Elton Turja	2133	Avioni i eshte blere A.E.E. Sh.p.k
6	A/N	18/07/16	ZENAIR	2011	STOL CH-701	7-8504	A.E.E Sh.p.k	ZA-EXN	DAMO	Besnik Lokollari	3316	

- 5.2 Çështjet Ligjore të Aviacionit dhe Harmonizmi i Legjislacionit

Gjatë vitit 2017 janë projektuar një sërë aktesh rregullatore, me miratimin e të cilave realizohet harmonizimi i kuadrit ligjor vendas me atë europian.

- Konkretisht në këtë drejtim janë projektuar aktet si më poshtë:
- Projektimin, përshtatjen dhe standartizmin e rregulloreve të BE në fushën e transportit ajror, tregullore të listuara në draft aneksin e përditësuar të Marrëveshjes së ECAA, që dërgohet cdo vit nga Komisioni European në AAC së bashku me vlerësimet e vizitave vlerësuese të rradhës të kryera në vendin tonë.
- Projektimin, përshtatjen dhe standartizmin në funksion të implementimit të Anekseve përkatëse të ICAO-s në legjislacionin vendas, si një bazë e rëndësishme rregulluese për funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil si autoriteti garantues dhe mbikqyrës i standardeve të transportit ajror.
- Standartizimin dhe dhënien e opinioneve ligjore për procedurat e brëndshme me karakter teknik, apo qarkoreve që nxirren e miratohen nga Drejtori Ekzekutiv i AAC-së, në përputhje me Ligjin 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, me qëllim zbatimin në praktikë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në fushën e sigurisë ajrore, shërbimit të lundrimit të trafikut ajror, sigurisë së aeroporteve, e rregulloreve për çështjet ekonomike, kryesisht të lidhura me operatorët ajrore në dobi të mbrojtjes së pasagjerëve. Kjo detyrë është thelbësore për përbushjen e detyrimeve në kuadrin e integrimit dhe bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil, sic janë ICAO- USOAP Audit Report, EASA- Accession and Standardisation Process, implementimi i Marrëveshjes së ECAA, në kuadër të krijimit të ZPEA-së.
- Komunikimin në mënyrë të vazhdueshme me institucionet ndërkombëtare, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në kuadër të raportimit të arritjeve dhe përbushjes së gjetjeve të rezultuara nga raportet përkatëse vlerësuese (konkretisht me KE).
- Në bashkëpunim me Drejtoritë teknike të AAC, pjesmarrje aktive në të gjitha auditimet e kryera për Autoritetin e Aviacionit Civil, si në kuadër të auditimit të brendshëm/ kombëtar dhe në kuadër të auditimeve të ndryshme ndërkombëtare, pavarësisht nga natyra e tyre teknike.
- Përveç materialeve të paraqitura e të planifikuara për DST, kjo drejtori ka përpiluar shkresa zyrtare të ngarkuara për t'u trajtuar nga Drejtori Ekzekutiv, për komunikimet brënda AAC dhe në marrdhënie të saj me të tretë(institucione publike apo private)

5.3 Kontrolli i Cilësisë dhe Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë

Funksioni i DKCSMS ka konsistuar në ushtrimin e kontrolleve të brëndshme të cilësisë, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirsim në AAC, raportimin e mospërpuethshmerive, menaxhimin e masave korrigjuese, zbatimi i Manualit të Cilësisë në përputhje me standartin ISO 9001:2008, i cili është dokumenti bazë për ngritjen e sistemit të menaxhimit të cilësisë në autoritet, duke unifikuar të gjitha hapat që do të ndiqen nga drejtoreti përkatëse në hartimin e rregulloreve, manualeve, proceseve, procedurave. Nëpërmjet këtij Manuali bëhet i mundur vodosja e parimeve kryesore të punës, rritja e cilësisë së punës si në planifikim ashtu dhe në raportim, identifikimi i dokumentave dhe qënia gjithmonë koherent me legjislacionin në fuqi dhe me versionin final, standartizimi i dokumentave nëpërmjet procedurës për menaxhimin e dokumentave, duke perfshirë në të të gjitha tiparet e detyrueshme që duhet të ketë një dokument qoftë ai i brëndshëm apo i jashtëm. Problematika ka konsistuar në mungesën e implementimit të standardeve të vodosura.

Kryesisht për vitin 2017 aktiviteti i drejtorisë ka konsistuar në:

- Janë shtuar në sistem informacione të rëndësishme për Protocol Questions dhe Corrective Action plans për disa kategori; USOAP
- Regjistrimi i ngjarjeve në programin ECCAIRS;
- Realizimi i planit të auditimit sipas programit;
- Auditimi follow-up pranë DZHTA;
- Auditimi follow-up i DAMO dhe sektori OPS;
- Rishikimi i kontrollit të cilësisë së tre proceseve të ardhura nga sektori FCL-DAMO: procesi për aprovim ekzaminues; procesi për vlefësimin e licences së huaj; procesi për konvertimin e licencës së huaj;
- Zhvillimi i Projektit EASA IPA 3 në 18-21 Prill me përfaqësues të EASAs Znj. Hazel Courtney;
- Plotësimi i gap analysis në sistemin iSTAR 3.0;
- Hedhje në sistemin USOAP ICAO e Diferencave Online të Anneksit 6 (Pjesa 1, 2, 3).
- Rishikimi dhe miratimi i procedurës “Për menaxhimin e dokumentave dhe planifikimin e punës në AAC”
- Me qëllim përbushjen e misionit dhe të objektivave të drejtorisë, në fokus për vitin 2017 kanë qënë edhe regjistrimi i vazhdueshëm i ngjarjeve të raportuara në programin ECCAIRS si dhe raportimi i vazhdueshëm në ICAO.

5.3.1 Statistikat në lidhje me ngjarjet e raportuara për vitin 2017


Monitorimi i sigurisë së avionit është pjesë integrale e funksioneve të ushtruara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë. Duke monitoruar nivelet e sigurisë në industrinë e aviacionit, AAC-ja mund të masë nëse rreziqet e sigurisë janë duke u vlerësuar në mënyrë të duhur dhe të identifikojë fushat në të cilat mund të përmirësohet siguria.

Raportimi i ngjarjeve kontribon në masë të madhe në identifikimin reaktiv dhe proaktiv të rreziqeve të sigurisë dhe ndikon në përmirësimin e masave të sigurisë.

Qëllimi i raportimit të ngjarjeve është përmirësimi i sigurisë ajrore duke garantuar që të dhënat përkatëse mbi sigurinë të reportohen, mblidhen, ruhen, mbrohen dhe shpërndahen. Qëllimi i vetëm i raportimit të ngjarjeve është parandalimi i aksidenteve dhe incidenteve dhe jo përcaktimi i fajit apo i përgjegjësisë.

Në këtë aneks janë paraqitur statistikat për ngjarjet e ndodhura gjatë vitit 2017. Në total në programin ECCAIRS janë regjistruar 392 ngjarje për vitin 2017, prej të cilave 59 janë probleme me linjat e AFTN-së me Brindisit, Beogradin, Athinën, Romën, Maqedoninë. Ngjarje të cilat nuk janë marrë në analizë sepse gjatë problemit është komunikuar nga teknika e vëndeve përkatëse se problemi është në pjësen e tyre.

Grafik.3: Numri i ngjarjeve të raportuara në Vitin 2017



Grafiku 3, tregon numrin e ngjarjeve të raportuara në AAC gjatë vitit 2017. Në përputhje me trendin e ngjarjeve të raportuara në vitin e mëparshëm, vërehet një ulje e ngjarjeve të raportuara gjatë tre majorit të parë të 2017. Ndërsa në periudhën Prill-Qershori 2017 vërehet një rritje e qëndrueshme dhe një numër uniform i raporteve. Numri i ngjarjeve të raportuara është më i lartë në periudhën Korrik-Dhjetor 2017. Kjo rritje është në përputhje me rritjen e aktivitetave të avionëve.

Në muajt Gusht dhe Dhjetor trendi arrin maksimumin e tij.


Kjo rritje është në përputhje me rritjen e aktivitetave komerçiale (aeroplanëve) gjatë muajve të verës dhe mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së *Submit me Laser*. Gjatë muajt Gusht AAC-ja ka marr 12 raportime në lidhje me sulmin me laser.

5.3.2 Statistika në lidhje me raportimin në USOAP

Kategoria State Activity Aviation Questionnaire: Në bashkëpunim me pikat e kontaktit kemi updateuar te gjitha pjeset.

Kategoria Self-Assessment e cila përbëhet nga: Protocol Questions, Corrective Action Plans dhe Findings & Reccomandation është duke u plotësuar. Pasqyra është si më poshtë:


Total PQ:	1099
Satisfactory:	425
N/S:	341
N/A	148



Në detaje sipas kategorive puna që është bëre gjatë kësaj periudhe. Grafiket janë bazuar te Non Satisfactory të çdo kategorie.

Kategoria Legislation

Total PQ:	28
S:	9
N/S	14
N/A	1



Kategoria Organisation

Total PQ:	29
S:	6
N/S	3
N/A	5



5.4 Mbikqyrja e Shërbimit të Lundrimit Ajror

Misioni i Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Navigimit Ajror është rritja e standardeve ne kryerjen e disa funksioneve kryesore përfshin operacionale siç janë:

1. Proçesi i Rregullbërjes në fushën e Shërbimeve te Navigimit Ajror
2. Proçesi i Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes se Ofrueseve te Shërbimeve te Navigimit Ajror
3. Liçensimi i Personelit te Ofruesve te Shërbimeve te Navigimit Ajror

Nga auditet e kryera në 2017, në fushat e ATS/AIS/CNS dhe TO situata është si më poshtë:

Gama e Vizites	Situasi Aktual
Verefikimi i UNC-ve	6 Te Mbyllura 3 te hapura 3 me shtese
ATS Area	3 Gjetje
MET	2 Gjetje
TO Area	7 Gjetje
Safety Area	1 Gjetje
CNS Area	5 Gjetje gjithsej 2 tē hapura

Aktualisht Albcontrol është i Certifikuar nga AAC sipas Reg MTI 115/2012 (EC Reg 1035/2011);

Në lidhje me burimet e ATCO situata rezulton sipas tabelës se meposhteme:

KTA	INST	VLERESUES KOMPETENCE
83	9	12

Nga këta 26 janë ATCO TWR.

- Raportimet në ATM.

Disa nga rezultatet e analizave të ngjarjeve në ATM per 2017 janë si më poshtë:
Ngjarjet e klasifikuara sipas ADREP Taxonomy.

Tabela e mëposhtme përmban të gjitha të dhënrat për totalin e ngjarjeve të raportuara gjatë vitiit 2017 dhe një krasim me vitin e kaluar 2016, bazuar në klasifikimin sipas ADREP Taxonomy. Në bazë të të dhënave të nxjerra nga databaza lidhur me numrin e ngjarjeve për çdo kategori dhe ashpërsinë që ka secila secila prej tyre, janë ndërtuar grafikët e mëposhtëm, të cilët ndihmojnë në kuptimin më të saktë të problematikave lidhur me ngjarjet dhe si janë të shpërndara këto problematika për secilin muaj.

Classification ADREP Taxonomy	2016	2017
	January- November	January- November
Bird Strike (BIRD)	27	13
Controlled flight into or toëard terrain CFIT	1	0
Airprox/ACAS alert/loss of separation/(near) midair collisions	5	9
MAC		
Runëay - Wildlife presence RI-A	3	1
Runëay incursion - vehicle, aircraft or person RI-VAP	1	1
System/component failure or malfunction [non-poëerplant]	3	6
SCF-NP		
ATM/CNS ATM	176	171
Fuel related FUEL	1	0
Aerodrome ADRM	2	3
Ëindshear or thunderstorm ËSTRË	9	1
Cabin safety events CABIN	3	4
Laser Illumination	12	45
Other	20	32

- Ngjarjet e vlerësuara me RAT

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënrat lidhur me ashpërsinë e ngjarjeve për vitin 2017 sipas vlerësimit që i është bërë me RAT (Risk Analysis Tool).

Severity	Frequency
Serious Incident	A5
Major Incident	B1, B3, B5
Significant Incident	C
Not Determined	D

Tabela Të dhëna lidhur me ashpërsinë e ngjarjeve Janar-Nëntor 2017

Pjesa më e madhe e ngjarjeve, 89% janë të klasifikuara me E (pa ndikimi në siguri). Siç shihet dhe nga të dhënrat vlen të theksohen dy ngjarje të klasifikuara si major dhe serious incident.

Cfarë lidhet edhe me TIA janë adresuar si gjatë auditeve tona por edhe në mbledhjet e RST me TIA dhe ANSP.

- Audit i EASA-s

Në lidhje me gjetjet e EASA, nga 12 Gjetje të auditit të 2017, janë mbyllur 9 prej tyre.

Nga tre të mbeturat, dy janë për tu mbyllur në 2018 dhe një është shtyrë si pasojë e shtyerjes që ka ardhur nga ANSP.

Në lidhje me 4 gjetjet që lidhen me Kodin Ajror të ri, AAC ka kërkuar shtryrje të afatit deri në Qershor 2018.

5.5 Mbikëqyrja e Aeroporteve dhe Aerodromeve

Drejtoria e Mbikqyrjes së Aerodromeve dhe Aeroporteve është përgjegjëse për kryerjen e certifikimit, regjistrimit, monitorimit dhe mbikëqyrjen e aeroporteve në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon dhe mbikëqyrë mjedisin fizik dhe teknik në afersi të aeroporteve në përputhje me rregullat në fuqi.

DMAA gjatë vitit 2017 ka kryer 28 inspektime sipas fushave të mëposhtme:

- Procedurat e hyrjes dhe manovrimit të mjeteve dhe personave në zonën ajrore;
- Në implementimin e SMS në aeroport;
- Shërbimin RFFS
- Menaxhimi i shpendëve dhe qenieve të gjalla.
- Përbashkëtje e kritereve dhe standardet e hapësirave për nivelin e shërbimit
- Pajisjet dhe Ndihmëset Vizuale (Ndricimi, Shenjat dhe Vijezimet)
- Shërbimi De-icing dhe Anti-Icing për aviononët dhe pistën
- Përpunimi i shërbimeve në tokë (groundhandling)

Në ato raste kur janë evidentuar mangësitë, u janë dërguar operatorit të aeroportit, i cili ka sjellë Planet e Veprimeve të Korrigjimit.

Operatori i aeroportit është në fazën e buxhetimit për rikonstruksionin e Pistës, e cila në vitin 2018 do te ri-bëhet e tëra.

Helipadi “VIVA” në Baldushk.

Ky është një heliport për operime private, i cili është regjistruar në AAC, ku i është dhënë një çertifikatë regjistrimi, por nuk është përfshirë në AIP.

Helipadi “Shega Air” në Rinas

Në Maj te vitit 2017, AAC ka lëshuar një leje për punë përgatitore për Helipadin e “Shega Air”, Rinas. Kjo e fundit pasi është pajisur me lejet ndërtimore dhe praktikat e nevojshme ka ndërtuar Helipadin në afersi të Aeroportit “Nënë Tereza”.

Ne muajin Korrik 2017, kompania “Shega Air” ka bërë kërkesë në AAC për Çertifikimin dhe regjistrimin e Helipadit të ndërtuar. Për këtë arsy me Urdhër të Brendshëm të drejtorit ekzekutiv është ngrejtur grupi për vlerësimin e kërkesës së kompanisë.

Ky proces është në vazhdim, jemi në pritje të dorëzimit të dokumentacionit shtesë nga kompania.

Në kuadër të hartimit dhe përmirësimit të kuadrit rregullator të Drejtorisë së DMAA në fushën e aeroporteve janë në proces për miratim këto ligje dhe rregullore:

- Rregullore mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit (e cila duhet të miratohet me VKM, aktualisht version draft në AAC);
- Është hartuar një Projekt rregullore “Për transportin ajror të mallrave të rrezikshme”, e cila është dërguar që në fillim të vitit 2014 në Ministri, por akoma nuk është shqyrtuar. Vlen të theksohet se kjo rregullore shërben për te gjithë aktivitetin e AAC, përfaktin se ka aplikim jo vetëm për aeroportin, por dhe për detyrat e operatorëve ajrore dhe sigurisë në trajtimin e mallrave të rrezikshme;
- Është hartuar një Projekt rregullore “Për furnizimin e avionëve me lëndë djegëse”, e cila është dërguar që në 10.11.2014 në Ministri, por akoma nuk është shqyrtuar. Kjo rregullore përcakton të gjitha kërkesa që duhet të plotësojnë depozituesit dhe furnizuesit e avionëve me karburant, si dhe i jep të drejtën AAC përfundimtare për kontrollin dhe inspektimin e këtyre sistemeve, gjë që deri tani nuk është bërë përfaktin se nuk ekziston asnjë akt ligor apo nënligjor që i jep të drejtën AAC përfundimtare;
- Është hartuar një projekt rregullore “Për hyrjen në tregun e shërbimeve të përpunimit në tokë në aeroportet e Shqipërisë”, e cila është dërguar në Ministri që në muajin Korrik 2015, por akoma nuk është shqyrtuar;
- Transpozimi i Rregullores së BE Nr.139 datë 12 Shkurt 2014
Kjo rregullore është përkthyer e përpunuar nga DMAA dhe është dërguar në Ministri që ne muajin Prill 2016 dhe pritet të shqyrtohet.

Me miratimin e kësaj rregullore, DMAA duhet të filloje punën përgatitore përfundimtare për hartimin e procedurave te konvertimit dhe materialeve përkatëse të nevojshme përfundimtare (siç janë Specifikimet e

Çertifikimit, Mjetet e Pranuara të Përputhshmërisë, Materialet Udhëzuese, format e aplikimit, listat e përputhshmërisë, etj).

Këto materiale duhet fillimisht të adoptohen nga stafi i DMAA nëpërmjet trajnimeve dhe pastaj ti shpërndahen operatorit te aerodromit, duke bërë trajnime të përbashkëta me operatorin e aerodromit dhe duhet të hartohet plani i konvertimit të Çertifikatës, realizimi i të cilës nuk duhet të kalojë datën 31.12.2018, date kjo që është vënë në projekt-rregulloren e paraqitur në Ministri.

5.6 Mbikqyrja e Sigurisë në Aviacion

Objktivi parësor i DMSA është mbikqyrja për zbatimin me efektivitet të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të pranuara, në fushën e sigurisë së avionit civil në Republikën e Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e avionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme që rrezikojnë sigurinë e avionit civil.

Për vitin 2017 aktiviteti i drejtorisë ka konsistuar në:

- Mbajtja trendit në rritje të numrit të aktiviteteve të monitorimit dhe të fushës së aktiviteteve të monitorimit, duke përfshirë të gjitha aeroportet, operatorët dhe entitetet që kanë përgjegjësi për zbatimin e standardeve të sigurisë së avionit.
- Ndërgjegjësimi i subjekteve dhe veçanërisht i TIA-s për t'u angazhuar siç kërkohet në kryerjen e veprimeve korriguese në rastet e mangësive të identikuara pas kryerjes së aktiviteteve të monitorimit (Mbyllja e Portës 3, përmirësimet në Portën A, kompletimi dhe hapja e Portës B për kontrollet e vlerave monetare, përmirësimet në cilësinë e CCTV, të rrëthimit të perimetrit, etj.).
- Përmirësimi i metodologjisë që përdoret në kryerjen e aktiviteteve të monitorimit, nëpërmjet adresimit të duhur të mangësive të identikuara, të cilësisë së raportimit dhe përdorimit të sistemit të harmonizuar të klasifikimit për nivelet e përputhshmërisë. Inspektimet tashmë shoqërohen tregullisht me vizita verifikuese pas inspektimit të kryer (follow-up).
- Kombinimi i pjesëmarrjes së inspektorëve, krahas ndjekjes së trajnimeve të ofruara nga ICAO dhe ose ECAC, në kryerjen e aktiviteteve të monitorimit ka sjellë tritjen e aftësive profesionale, të cilat mirëmbahan në vazhdimësi.
- Përgatitja dhe dorëzimi i disa projektakteve në interes të përmirësimit të kuadrit rregulator të fushës së sigurisë së avionit dhe dispozitat e lidhura me sigurinë përfacilitetet.
- Pjesëmarrja efektive në grupe pune, komisione brenda e jashtë institucionit.
- Bashkëpunimin efektiv në nivel rajonal e më gjërë që ka mundësuar njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave të punës.
- Shtimi i listës së Instruktorëve të Sigurisë pas shqyrtimit dhe miratimit përf Instruktor të B. Karolit përf Modilin 1, për personelin e ALBCONTROL SHA.
- Përfundimi i proçesit të miratimit të subjektit ICSI Albania si Furnizues i Rregullt përf Furnizimet në fluturim pas verifikimit të përmbytjes së kushteve dhe kërkesave të përcaktuara nga rregulloret në fuqi.

- Rreth 2.6 milion pasagjerë kanë qënë objekt i kontrolleve të sigurisë së avacionit, pa përfshirë këtu dhjetra e qindra persona të tjerë jo pasagjerë që janë kontrolluar ndërsa kanë pasur arsyesh për të hyrë në zonat e kufizuara të sigurisë të aeroportit TIA;
- Mesatarisht, rreth mbi 7.200 pasagjerë kontrollohen/skanohen çdo ditë;
- 13,419 artikuj të ndaluar janë konfiskuar nga agjentët e sigurisë;
- 3 armë automatike janë konfiskuar gjatë kontrollit të një dërgese Kargo, rast i parë i një tentative për kalimin e paligjshëm të armëve nëpërmjet rrugës ajrore;
- 2,226 ton kargo dhe postë ajrore është kontrolluar para transportit në rrugë ajrore (*1,811 tons Cargo & 455 tons Mail*);
- 811 persona të tjerë, jo pasagjerë kanë marrë trajnimin për ndërgjegjësimin për sigurinë e avacionit civil, i detyrueshëm për çdo person që për arsyesh operacionale kërkon të pajiset me fletëhyrje permanente, që i garanton atij/ asaj hyrje të pashoqëtaruar në zonën e kufizuar të sigurisë në aeroport;
- Mesatarisht 80 persona në muaj e marrin këtë trajnim;

Sic dihet DMSA nuk është e përfshirë drejtëpërdrejtë në zbatimin e masave të sigurisë, por ushtron përgjegjësitë ligjore në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kërkesave rregullatore dhe në monitorimet për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare. Në misionin për garantimin e sigurisë së avacionit civil ne nuk jemi vetëm. Bashkë me ne si pjesë e pazgjidhshme e sistemit kombëtar të sigurisë së avacionit civil janë edhe:

- 139 (nga 130 për 2016) agjentë sigurie të ICTS Albania, të nënkontraktorit për shërbimet e sigurisë që shërbejnë çdo ditë, me tre turne në aeroport, në pozicione të ndryshme si agjent për shërbimin e patrullës, operatorë skaneri, etj.
- 31 vet, personel i sigurisë për ATM Security/ALBCONTROL SHA;
- 17 punonjës në TIA/ Agjent i Rregullt për Kargon dhe Postën Ajrore;
- 10 punonjës në ICSI Shpk që kryen furnizimet e Kateringut.

Janë kryer 7 inspektime të panjohuara në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” dhe *follow-up* përkatës sipas rastit.

Në lidhje me ndjekjen e procedurave për trajnimin dhe çertifikimin e personelit janë permbushur detyrat si më poshtë:

- Është analizuar dosja e Znj. Klarita Angjeli dhe në vijim është ndjekur dhe përfunduar procesi i çertifikimit të saj si Instruktore e Sigurisë.
- Janë analizuar dosjet e Znj. Valbona Kondaj dhe Znj. Aurora Zogu dhe në vijim ka përfunduar procesi i riçertifikimit si Instruktore të Sigurisë së Avacionit të Kompanisë ICTS Albania.

- Është analizuar dosja e Z. Besnik Karoli dhe në vijim është ndjekur dhe përfunduar procesi i certifikimit të tij si Instruktor i Sigurisë për Modulin 1 të PKTSAC, për shoqërinë Albcontrol SHA.
- Ka përfunduar procesi i certifikimit i të gjithë personelit të ri të sigurisë së Kompanisë ICTS Albania. Janë certifikuar gjithsej 41 persona.
- Ka përfunduar procesi i riçertifikimit të të gjithë personelit të sigurisë së Kompanisë ICTS Albania, pas ndjekjes së trajnimeve rifresuese vjetore. Është përfunduar procesi i riçertifikimit për 150 persona nga stafi i ICTS Albania.

-
- **5.7 Zhvillimi i Transportit Ajror dhe Çështjet e Mjedisit**

Përgjatë vitit 2017 progresi i punës së DZHTA-s konsiston në:

- Shqyrtimi i çdo kërkesë të paraqitur për pajisjen me clerancë të të gjitha rasteve privat, ambulance, ushtarak, diplomatik, komercial, ferry, skedul sipas Kodit Ajror të RSH-së, rrugëve ajrore, si dhe lirive të të drejtave të trafikut siç është përcaktuar në Kodin Ajror të RSH-së dhe AIP);
- Miratimi i Programit Veror të fluturimeve, Mars – Tetor 2017 dhe Programit Dimëror të fluturimeve Nëntor – Mars 2018 për 30 kompani ajrore, të cilat kryejnë fluturime të rregullta dhe charter.
- Monitorim dhe inspeksiime të vazhdueshme në TIA, ndaj zbatimit të detyrimeve nga kompanitë ajrore të të drejtave të pasagjerit, në përbushje dhe zbatim të legjislacionit europian dhe atij shqiptar.
- Në funksion të fushatës: “E drejta nuk vonon, AAC avokati juaj në mbrotje të të drejtave të cenuara”, është punuar për riprodhimin e udhëzuesve informativ dhe tabelave informuese, duke i rikompozuar ato në formë dhe përbajtje.
- Mbledhjen e të ardhurave të AAC me **2.825.000 lekë** nga Ferry Flight dhe Test Flight të pajisura me numër klerance;
- Ndjekja e procedurës për pajisjet me cleranca diplomatike, kalimi Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Albcontrol-it.
- Përditësimi i regjistrat me clerancat e dhëna për periudhën Janar – Dhjetor 2017, përpilimi i evidencave për të gjitha lejet e mësipërme.
- Ndjekje e vazhdueshme e perfomancës se operatorëve ajrorë në tregun shqiptar dhe raportimi në bazë mujore;
- Njoftime dhe raporime periodike te DE në lidhje me problematikën e konstatuar në performancën e operatorëve ajrorë në treg;
- Monitorimi në vazhdimësi i orareve si edhe vonesave dhe anullimeve të fluturimeve në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, dhe u është kërkuar informacion kompanive ajrore se çfarë shërbimesh kanë ofruar për të asistuar pasagjerët;

- Është dërguar letër në kompaninë ajrore “Albaëings”, për monitorimin e përputhshmërisë ekonomiko – financiare të saj.
- Në bazë të ngjarjeve (vonesa dhe anullime) në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, janë kryer inspektime mbi të drejtat e pasagjerëve ne bazë te parashikimeve të Udhëzimit Nr.1, datë 26.02.2013, “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve”, si dhe janë asistuar pasagjerët në plotësimin e formularëve të ankimit;
- Përpunimi në bazë mujore i të dhënave statistikore të numrit te pasagjerëve që udhëtojnë për/nga Aeroporti Nderkombetar “Nënë Tereza” numri i fluturimeve, numri i mbikalimeve charter, numri i kompanive ajrore, numri i destinacioneve, numri i mbikalimeve dhe fluturimeve;
- Përgatitja e analizës tre-mujore, gjashtë-mujore nentë-mujore të treguesve ekonomikë dhe performanca e operatorevë ajrorë gjatë periudhës janar – dhjetor 2017, shpeshtësia e rasteve problematike, inspektimet e kryera në TIA për asistimin e pasagjerëve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 1, datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe

5.8. Çështje të Administratës dhe Përfaqësimit Ligjore

Statusi i Nënpunësit Civil

Me miratimin e strukturës së AAC-se, me vendim nr. 100 dt. 26.02.2014, dhe shtimi i kësaj strukture me Vendimin nr. 60, datë 21.11.2016, dhe Vendimin 69, datë 12.04.2018 të KD të AAC, solli që zbatimi i kësaj strukture të ketë ndryshime të pozicioneve të punës si dhe lëvizje brënda sektorëve të cilat kanë rezultuar të pa rregullta për efekt të ligjit “Për Nëpunësin Civil” kjo e konstatuar nga KMSHC.

Për këtë arsye Sektori i Burimeve Njerëzore ka kryer evidentimin e punonjësve të cilët rezultonin me akte emërimi të parregullta në kundërshtim me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe kemi komunikuar me DAP dhe KMSHC për zgjidhje të problemit.

Gjatë vitit 2017 janë kthyer në pozicionet e tyre të rregullta 2 punonjës;

- Janë larguar nga puna me dorëheqje 14 punonjës;
- Janë larguar nga puna si rezultat i përfundimit të kontratës së punës 7 punonjës;
- Janë larguar nga puna me procedurë largimi 2 punonjës;
- Eshtë larguar nga puna për thyerje të etikës 1 punonjës;
- Janë larguar nga puna me akte absolutisht të pavlefshëm 9 punonjës;
- Eshtë liruar nga shërbimi civil 1 punonjës.
- Janë emëruar 35 punonjës me kontratë pune.

Me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr. 79, datë 21.12.2017 dhe miratuar nga nga Ministri i MIE është ngritur Komisioni i Ristrukturimit i cili konstiston në përafrimin dhe pozicionimin e seilit punonjës në vendet e punës në përputhje me kriteret, arsimin dhe trajnimet.

Sektori i Prokurimeve

- Në zbatim të programit ekonomiko-financiar, sipas plan buxhetit të miratuar për vitin 2017, sektori i prokurimeve ka bërë të mundur prokurimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit për të plotësuar në kohë nevojat për shërbime dhe materiale për një funksionim sa më të mirë të institucionit. Është punuar me kujdes dhe prioritet për ato shërbime të cilat për vet karakterin e tyre janë të përvitshme dhe kryhen në mënyrë të përsëritshme, ndaj të cilave kemi hasur gjithmon vështirësi për realizimin e tyre në kohë. Këtu mund të përmendim shërbimet si ruajtja dhe siguria e godinës së AAC-së dhe aeroportit të Kukësit apo blerja e karburantit për nevoja vjetore të Institucionit.
- Është bërë hartimi i regjistrat të parashikimeve të prokurimeve të AAC-së brënda afateve ligjore në përputhje me ligjin e prokurimit publik dhe VKM-se për rregullat e prokurimit dhe dërgimin e tyre brenda afateve në Insitucionet e përkatësise.
- Janë kryer trajnimet e nevojshme për stafin e prokurimeve për atë pjesë të personelit të pa trajnuar. Këto trajnime janë kryer pranë organizatorëve të trajnimeve si Shkolla Shqipetare për Administratën Publike, Agjensia e Prokurimit Publike, etj.
- Është bërë administrimi i mirë i dokumentacionit të prokurimeve, trajtim i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomik të cilët kanë shfaqur interes për procedurat që ne kemi prokuruar për punë, mallra e shërbime.
- Janë krijuar kushte dhe lehtësira dhe janë ndjekur e ndihmuar grupet e punës të cilat ngarkohen të marrin pjesë në procedurat e prokurimit që nga hartuesit e specifikimeve teknike, termave të referencës, përllogaritjes së fondeve, komisionet e vlerësimit, grupet e ndryshme për shqyrtimin e ankesave (kur ka të tilla), grupet e marrjes në dorëzim apo të ndjekjes dhe zbatimit të kontratave etj, në mënyrë që të mos pengohen procedurat dhe të plotësohen nevojat e institucionit në kohë sa më të shpejtë dhe reale.
- Në përfundim të vitit ushtrimor janë dërguar pranë APP-së rregjistrimi i realizimeve i cili i hap rrugë në vazhdim kryerjes së inventarizimit të dosjeve të procedurave të prokurimit dhe arkivimit të tyre.

Përfaqësimi ligjor

Gjatë 12-mujorit të vitit 2017 janë ndjekur një sërë çështjesh gjyqësore. Një pjesë e tyre ka qenë e mbartur, në proces nga viti i kaluar, dhe disa të reja të nisura në vitin 2014. Në të gjitha çështjet, AAC ka qenë palë e paditur.

Më poshtë po paraqesim një tablo të plotë të çështjeve të ndjekura gjatë vitit 2017 dhe statusin aktual për secilën çështje:

- 1- Çështja Civile me Padites “Vodafone Albania” sh.p.k dhe të Paditur AAC-në. Është në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë Administrative (të dyja shkallët e para i ka fituar AAC-ja).
- 2- Çështja Civile me Paditës “ Besa Veizaj ” dhe të Paditur AAC-në. Është në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë Administrative (të dyja shkallët e para i ka fituar znj. Besa Veizaj).
- 3- Çështja Civile me Paditës “Shega Air” sh.p.k dhe të Paditur AAC-në. Është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit (shkallën e parë e ka fituar shoqëria “Shega Air” sh.p.k.

5.9 Ceshtjet Ekonomike

Në zbatim të detyrave të caktuara dhe përbushjen e përgjegjësive më poshtë po japim rezultatet e arritura për vitin 2017:

a. Të ardhurat

Sipas Ligjit “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” Nr. 10233 datë 11.02.2010, nen 17, të ardhurat e Autoritetit realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti.

000/Lekë

Nr	Emërimi	Realizimi Vjetor 2016	Programi vjetor 2017	Realizimi Vjetor 2017	% Realizimi 2017/2016	% Realizimit 2017/plan 2017
A	Të ardhurat me "fonde të veta"	345,896	329,500	353,814	102%	107%
1	Tarifa e sigurisë	151,305	149,955	178,405	118%	119%
2	Tarifa e kostos në rrugë (en -route)	162,000	162,000	162,000	100%	100%
3	Liçenca e Aeroportit	6,991	7,000	6,788	97%	97%
4	Të ardhura nga Liçenca të tjera	10,041	8,500	4,010	40%	47%
B	Të ardhura të tjera	15,559		2,611		
	TOTALI(A+B)	345,896	329,500	353,814		

Duke ju referuar tabelës së mësipërme:

- **Tarifa e Sigurisë** - Të ardhurat nga ky aktivitet për vitin 2017 janë realizuar në masën 19 % më shumë krahasuar me parashikimin vjetor dhe 18% më shumë krahasuar me realizimin e kësaj të ardhure për vitin 2016. Ky tejkalim ka ardhur si ndikim i rritjes së numurit të pasagjerëve të trajtuar në Aeroportin “Nënë Tereza” dhe konkretisht një rritje prej 19% më shumë krahasuar me vitin 2016.
- **Tarifa e kostos en-route**, është bërë kalkulimi kostos bazë (unit rate) për Shqipërinë, sipas metodologjisë së Eurokontrollit. Kjo e ardhur merret nëpërmjet ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror Albcontrol, duke qenë se tarifa en-route arkëtohet në total bashkë me koston e Albcontrol-it. Vlen të theksohet se kjo kosto është variable dhe reflekton vetëm shpenzimet që bën realisht Institucioni për këtë aktivitet. Realizimi për këtë zë është i plotë në masën 100%. Tarifa e rrugës përbën një nga treuesit kryesorë të të ardhurave të Autoritetit, duke përfaqësuar 50% të të ardhurave totale. Të ardhurat nga tarifat e rrugës, për vitin 2017, rezulton me një vlerë 162 milionë Lekë. Duke qenë se parashikimi kostos bëhet për një periudhë pesë vjeçare më poshtë po japim koston bazë në vite me një parashikim deri në vitin 2022.

Vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Kosto bazë	131	147	162	162	167	164	163	163	162

***Liçensa e Aeroportit**, e cila është e përcaktuar në Ligjin Për ratifikimin e marrëveshjes së koncessionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncessionare Tirana Airport Partners, shpk, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimujve kësaj Shoqërie dhe është një shumë fikse prej 50,000 Euro. Kjo shumë paguhet në një pagesë të vetme nga Aeroporti. Diferenca me parashikimin reflekton kursin e këmbimit në monedhën Euro.

***Të ardhura të tjera nga licencat** përfshihen të ardhurat që ne vjelim nga dhënia e liçensave në fushën e aviacionit civil, në bazë të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrit të Financave, Nr. 2225 datë 13/05/2013. Kjo e ardhur është realizuar afersisht në masën 47% krahasuar me parashikimin 2017, kurse krahasuar me realizimin për vitin 2016 rezulton në masën 40%, pasi në të ardhurat e 2016 përfshihet vlera e liçensimit të Kompanisë Shqiptare Albaëings shpk.

***Të ardhura të tjera përfshihen** të ardhurat nga komisionet bankare, si dhe shuma të derdhura nga punonjësit në zbatim të rekomandimeve të KLSH dhe auditit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

b). Shpenzimet

Autoriteti i Aviacionit Civil, në bazë të pikës 4 të nenit 17 të Ligjit “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i përdor të ardhurat e saj me qëllim mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale të nevojshme për funksionimin normal të saj, si dhe për pagesat e kontributeve, që rrjedhin nga antarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil.

Totali i shpenzimeve deri në fund të vitit 2017 rezulton në shumën 301,357 mijë Lekë kundrejt 332,758 mijë Lekë të parashikuara në planin e miratuar të buxhetit.

Në tabelën e mëposhtëme paraqitet një krahasim i shpenzimeve të realizuara për vitin 2017 kundrejt programit të miratuar:

Nr	Emertimi	Programi vjetor 2017	Realizimi Vjetor 2017	Lëvizjet në vlerë absolute	% realizimit 2017/plan 2017
1	Mallra	11,440	10,235	(1,205)	90
2	Furnitura dhe shërbime	28,408	23,723	(4,685)	83
3	Shërbime gjithsej	30,050	25,862	(4,188)	85
4	Trainim stafi dhe trajtim personeli	10,926	12,443	1,517	100
5	Tatim taksa të tjera	11,070	10,245	(825)	93
6	Shpenzime personeli	233,864	203,693	(30,171)	87
7	Shpenzime të tjera rrjedhëse	2,200	797	(1,403)	36
8	Shpenzime financiare	300	1,898	1,598	40
9	Provizione (vendime gjyqsore)		1,513	1,513	
10	Amortizimi aktiveve afat gjata	4,500	10,948	6,448	243
	Totali	332,758	301,357	31,401	91

Investimet

Bazuar në programin e investimeve për vitin 2017, AAC programoi që të realizonte investime të finançuara nga "burimet e veta", me vlerë totale 4.784 mijë lekë të ndara këto sipas strukturës se mëposhtme. Realizimi i detajuar sipas zërave jepet në vlerë absolute dhe në përqindje kundrejt planit në tabelën e mëposhtme:

		VITI 2017		
Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	

				% realizimit /planit
A	Totali i Invest me fonde të veta (I+II+III)	4,784	6,498	136
I	Ndërtime e Montime	130	14	
A/I/ 1	Regjistrimi pronave dhe objekteve në hipotekë (Aeroporti Kukës)	130	14	
II	Pajisje zyre, pajisje informatike & elektronike	1,000	2,453	
A/II /1	Facilitete kompjuterike	1,000	2,375	
A/II /2	Të tjera		78	
III	Aktive të patrupëzuara	3,654	3,971	
A/II 1/1	Database Komunikimi Elektronik	3,654	1,014	
A/II I/2	Studim fizibilitetit për ndërtimin e një Aeroporti në Jug		2,957	

Investimet janë realizuar në shumën 6,498 mijë Lekë, e cila përfaqëson 36% më shumë se parashikimi. Nënzëri “*Regjistrimi pronave dhe objekteve në hipotekë (Aeroporti Kukës)*” është realizuar në masën 10% të parashikimit, pasi ky është një proces që ka filluar por që do të zgjasë në kohë.

Nënzëri “*studimin e fizibilitetit për ndërtimin e një aeroporti në jug të vendit*”, ka qenë programuar në vitin 2016, referuar VKM nr. 564, datë 29.07.2016 “Për ngarkimin e Ministrisë së Transporteve dhe infrastrukturës, si organ qëndror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të Autoritetit të Aviacionit Civil”. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ngarkohej për kryerjen e procedurës së prokurimit për llogari të AAC-së për këtë projekt. Fondi limit që do të prokurohej ishte 30,000 mijë lekë, nga të cilat 10,000 mijë lekë të programuara nga AAC dhe 20,000 mijë lekë nga Albkontrol. Kontrata është përfunduar në vlerën totale 29,000 mijë lekë. Gjatë vitit 2017 është paguar vetëm 10% e vlerës totale të kontratës, në shumën 2,957 mijë lekë, e cila përfaqëson vlerën e raportit fillestare që ka dalë mbi bazën e vlerësimit paraprak të dokumentave dhe burimeve që do përdoren për përbushjen e objektit të kontratës.

4. Progresi punës

Duke konsideruar natyrën specifike të Drejtorisë Ekonomike, ku përfshihen Sektori i Financës dhe Kontabilitetit, si dhe ai i planifikimit, detyrat për të cilat kjo drejtori është përgjegjëse janë realizuar në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 6942 datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, Ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimin e Ministrisë së Fianacave Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit publik”, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që prodhojnë efekte financiare.

Përsa i përket shifrave të kostos bazë dhe unit rate për vitin 2017-2021, vlerësimi i tyre është bërë në përputhje të plotë me dokumentin e Eurokontrollit, “Parimet për përcaktimin e kostos bazë për pagesat gjatë udhëtimeve në korridoret ajrore dhe për llogaritjen e kurseve të njësisë”, të cilat u finalizuan në Sesionin e Nëntorit 2016 të Komitetit të Zgjeruar.

6. STATISTIKAT

Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Departamenti i Marketingut të Linjave Ajrore, viti 2017 karakterizohet nga një fluks në rritje i pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet transportit ajror. Shifrat referojnë një numër prej 2.630.380 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 (171.546 prej tyre kanë udhëtuar me linja charter).

Katërmujori Qershori-Shtator i vitit ka regjistruar rrëth gjysmën e këtij fluksi, 1.118.069 pasagjerë ose rrëth 43%, nga ku muajji gusht shënon pikun më të lartë me 328.317 pasagjerë ose rrëth 12.5% të totalit vjetor. Grafiku i mëposhtëm paraqet fluksin e pasagjerëve që kanë udhëtuar përgjatë vitit 2017, të ndarë sipas muajve.

Grafiku 1: Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar për/nga TIA për vitin 2017 sipas muajve





Tabela 1: Lëvizja e pasagjerëve sipas muajve dhe operatorëve ajrorë periodhën në Janar – Dhjetor 2017, referuar operatorëve ajrorë.

Nr	Shoqëri Ajrore	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTAL	%
1	Adria Airëays	7,167	5,736	6,736	10,050	7,890	8,121	13,436	16,140	12,216	10,070	8,133	8,952	114,647	4.36%
2	Alitalia	20,731	16,988	20,780	22,715	23,551	27,291	31,077	31,993	27,423	24,121	18,069	17,536	282,275	10.73%
3	Austrian Airlines	9,915	7,455	12,099	17,002	17,124	17,070	18,934	18,271	17,559	16,753	11,562	10,619	174,363	6.63%
4	British Airëays	6,191	6,017	5,744	6,186	6,521	6,296	7,757	8,774	8,273	7,263	7,536	8,092	84,650	3.22%
5	Jetairfly	3,729	3,494	4,047	3,539	4,114	3,453	3,868	4,419	3,780	3,870	3,606	3,892	45,811	1.74%
6	Lufthansa	5,749	4,823	5,373	4,529	4,699	5,558	5,895	5,459	5,376	5,129	4,749	3,897	61,236	2.33%
7	Aegean Airlines	6,076	4,647	6,020	6,181	6,687	7,600	8,415	9,143	8,109	7,229	7,308	7,445	84,860	3.23%
8	Turkish Airlines	10,825	10,222	13,236	13,723	14,330	14,628	16,074	17,168	16,705	17,957	14,048	13,803	172,719	6.57%
9	Pegasus Airlines	4,747	4,322	6,279	4,638	5,424	8,376	11,356	17,150	11,009	4,435	5,141	6,388	89,265	3.39%
10	Blue Panorama	74,080	41,396	55,612	74,101	65,214	64,962	65,038	67,175	53,445	52,789	50,698	72,658	737,168	28.03%
11	Air Serbia	2,236	1,945	3,132	4,246	4,494	4,477	5,535	5,709	5,231	4,514	2,696	2,911	47,126	1.79%


AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

12	Mistral Air	13,678	13,766	13,398	-	-	-	7,652	8,032	6,809	7,008	4,029	5,823	80,195	3.05%
13	Albaëngs	23,869	17,693	20,957	16,715	17,910	17,369	18,025	19,000	14,491	12,279	12,360	17,593	208,261	7.92%
14	Volotea	689	-	-	1,418	1,936	1,698	1,770	1,777	1,888	-	-	-	11,176	0.42%
15	Élizz Air	-	-	-	2,467	2,680	2,395	2,882	3,236	4,022	3,943	4,295	4,401	30,321	1.15%
16	Transavia	-	-	-	-	7,193	7,267	8,764	8,999	8,018	6,962	3,449	-	50,652	1.93%
17	Ernest Airlines	-	-	-	-	-	11,662	18,751	28,350	33,984	30,231	27,384	33,705	184,067	7.00%
	SHUMA	189,682	138,504	173,413	187,510	189,767	208,223	245,229	270,795	238,338	214,553	185,063	217,715	2,458,792	93.48%


Grafiku 2: Lëvizja e pasagjerëve për vitin 2017 sipas operatorëve ajrorë

Si destinacion më i preferuar për pasagjerët që udhëtojnë për/nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, është Roma me 12% ndaj totalit, duke vazhduar me Milanon e cila zotëron 10% ndaj totalit. Destinacionet me përqindjen më të ulët janë disa destinacione për të cilat ka kërkesë vetëm gjatë sezonit të verës apo dimrit (destinacionet e Turqisë, Polonisë, Ukrainës). Më poshtë paraqitet grafikisht fluksi i pasagjerëve sipas shteteve.

Grafiku 3: Lëvizja e pasagjerëve për vitin 2017 sipas destinacioneve



Grafiku 4: Lëvizja e pasagjerëve për vitin 2017 sipas shteteve



Referuar të dhënave mbi numrin e pasagjerëve, Italia kap përqindjen më të madhe të tregut të transportit ajror për vitin 2017, duke zënë rreth 57% të totalit, ndjekur nga Turqia me 11% dhe Austria me 7%.

Ky fakt, reflektohet dhe me rritjen e numrit të pasagjerëve për kompaninë ajrore “Blue Panorama”, e cila ka mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për vitin 2017, me një numër prej 737,168 pasagjerë ose rrëth 28.03% të totalit. Ndjekur nga “Alitalia” me një numër prej 282,275 pasagjerë ose rrëth 10.7% të totalit, “Mistral Air” me 208,261 pasagjerë ose rrëth 7.9% të totalit dhe “Ernest Airlines” me 184,067 pasagjerë ose rrëth 7% të totalit vjetor.

Nësë referuar shifrave do të analizonim ecurinë e tregut të transportit ajror në vendin tonë për periudhën tre vjeçare 2015-2017, vëmë re se kemi një tendencë në rritje të tregut të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit, vit pas viti.

Në mënyrë krahasimore më dy vitet paraardhëse, viti 2017 siç u theksua që në fillim, shënon një rritje të fluksit të pasagjerëve. Konkretisht, krahasimisht me vitin 2015, viti 2017 ka shënuar një rritje prej 33% dhe krahasimisht me 2016 rritja në 2017 ka qënë rrëth 20%.

Nisur nga të dhënat mbi operatorët ajrorë, për sa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për tre vitet e referuar, vëmë re se numri i pasagjerëve që kanë fluturuar me kompaninë “Blue Panorama” në vitin 2017 ka shënuar një rritje prej 7.6% krahasuar me vitin 2016, dhe 46% krahasuar me vitin 2015. Alitalia ka humbur treg, duke shënuar një rënje të pasagjerëve për vitin 2017 rrëth -33,49% krahasuar me vitin 2016 dhe rrëth -55% krahasuar me vitin 2015. Kompania ajrore Mistral Air ka një rritje në numrin e pasagjerëve që kanë zgjedhur të udhëtojnë me të në vitin 2017 me rrëth 5% krahasuar me 2016.

Përsa i përket kompanisë ajrore “Ernest Airlines” shoqëria ka hyrë në treg në korrik të vitit 2017, dhe gjatë këtij viti me këtë kompani kanë udhëtuar për/ nga TIA 184.067 pasagjerë, duke zotëruar 7 % të tregut.

Tabela e mëposhtme jep një informacion të plotë krahasimor për tre vitet e fundit të numrit të pasagjerëve sipas shoqërive ajrore, duke treguar qartazi tendencën në rritje të numrit të pasagjerëve nga viti në vit.


Tabela 2: Numri i pasagjerëve sipas kompanive ajrore

PASAGJERË - 2015 - 2016 - 2017						
Nr	Shoqëri Ajrore	2015	2016	2017	% e rritjes/ zbritjes te 2016 kundrejt 2015	% e rritjes/ zbritjes te 2017 kundrejt 2016
1	Adria Airëays	103,890	106,758	114,647	2.76%	7.39%
2	Alitalia	633,716	424,385	282,275	-33.03%	-33.49%
3	Austrian Airlines	143,170	159,109	174,363	11.13%	9.59%

4	British Airëays	62,417	73,260	84,650	17.37%	15.55%
5	Jetairfly	40,367	42,309	45,811	4.81%	8.28%
6	Lufthansa	60,472	60,278	61,236	-0.32%	1.59%
7	Aegean Airlines	70,530	78,349	84,860	11.09%	8.31%
8	Turkish Airlines	148,428	153,369	172,719	3.33%	12.62%
9	Pegasus Airlines	67,159	65,234	89,265	-2.87%	36.84%
10	Blue Panorama	503,556	685,054	737,168	36.04%	7.61%
11	Air Serbia	30,559	41,107	47,126	34.52%	14.64%
12	Albaëings	-	55,666	208,261	-	274.13%
13	Air Valle	15,294	7,316	-	-52.16%	-
14	Volotea	-	17,628	11,176	-	-36.60%
15	Mistral Air	-	76,581	80,195	-	4.72%
16	Ëizz Air	-	-	30,321	-	-
17	Transavia	-	-	50,652	-	-
18	Ernest Airlines	-	-	184,067	-	-
	SHUMA	1,879,558	2,046,403	2,458,792	8.88%	20.15%
19	CHARTER	97,486	148,697	171,546	52.53%	15.37%
	TOTAL	1,977,044	2,195,100	2,630,338	11.03%	19.83%

Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve të periudhës Janar – Dhjetor 2017 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2015 dhe 2016:

Grafiku 5: Numri i pasagjerëve për periudhën 2015-2017 sipas operatorëve ajrorë




Për sa i përket transportit të ngarkesës Cargo gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017 ka një rritje në përqindje prej 2.99 % kundrejt 2016 dhe 1.9% krahasuar me vitin 2015. Statistika më të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme

Tabela 3: Transporti Cargo sipas operatorëve ajrorë. Periudha 2015-2017

Nr	Shoqeri Ajrore	CARGO (kg) - 2015-2016-2017			% e rritjes/ zbritjes te 2016 kundrejt 2015	% e rritjes/ zbritjes te 2017 kundrejt 2016
		2015	2016	2017		
1	Séift Air	433,029	470,179	492,483	8.58%	4.74%
2	Adria Airéays	159,134	159,511	210,960	0.24%	32.25%
3	Alitalia	289,281	273,913	222,891	-5.31%	-18.63%
4	Austrian Airlines	440,510	438,129	495,070	-0.54%	13.00%
5	British Airéays	27,951	12,613	28,842	-54.87%	128.67%
6	Jetairfly	-	398	723	-	81.66%
7	Lufthansa	94	26,182	34,999	27753.19%	33.68%
8	Aegean Airlines	192,498	206,355	183,470	7.20%	-11.09%
9	Turkish Airlines	449,741	419,714	399,673	-6.68%	-4.77%
10	Pegasus Airlines	60,267	80,206	59,031	33.08%	-26.40%
11	Blue Panorama	11,426	36,109	49,938	216.02%	38.30%
12	Air Serbia	43,866	64,487	56,828	47.01%	-11.88%
13	Cargo Truck	89,412	-	2,996	-	-
	SHUMA	2,197,209	2,187,796	2,237,904	-0.43%	2.29%
14	CHARTER	32,199	11,936	27,651	-62.93%	131.66%
	TOTAL	2,229,408	2,199,732	2,265,555	-1.33%	2.99%

Ngarkesa e cargos sipas shoqërive ajrore për periudhën Janar – Dhjetor 2017 në tre vitet e fundit paraqitet grafikisht:

Grafiku 6: Transporti Cargo sipas operatorëve ajrorë. Periudha 2015-2017



207. 724

Vit. 10.03.2018

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR DHE
PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31.12.2017

Permbajtja:

Raporti i audituesit te pavarur.....	1-2
Pozicioni Financiar ne 31 dhjetor 2017.....	3
Pasqyra e performances per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2017	4
Pasqyra e flukseve te parase per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2017	5
Pasqyra e ndryshimeve ne kapitale per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2017.....	6
Shenimet Shpejguese te Pasqyrave Financiare.....	7-21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për: Manazhimin dhe Keshillin Drejtues te Autoriteti i Aviacionit Civil

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Shoqerise Autoriteti i Aviacionit Civil, te cilat perbehen nga pozicioni finanziar ne daten 31 dhjetor 2017, pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese, pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve te parave per vitin e mbyllur ne kete date, si dhe shenimet e pasqyrave financiare, perfshire nje permblehdje te metodave me te rendesishme kontabel.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare, jepin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te pozicionit finanziar te Shoqerise Autoriteti i Aviacionit Civil, me 31 dhjetor 2017, te performances se saj financiare dhe te flukseve te saj te parave per vitin e mbyllur ne kete date, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.(SKK)

Baza per opinionin

Auditimi yne u be ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Pergjegjesia jone, sipas ketyre standarteve eshte pershkruar me tej ne kete raport, ne paragrafin Pergjegjesia e Audituesit per Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi te pavuar nga shoqeria, ne perputhje me kerkesat etike qe lidhen me auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi dhe kemi plotesuar pergjegjesite e tjera etike, ne perputhje me keto kerkesa. Ne besojme qe evidencia e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per dhenien e opinionit te auditimit.

Pergjegjesite e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqerise eshte perqejges per perqatjen e drejtë te pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit dhe per ato kontolle te brendshme, qe drejtimi i percakton te nevojshme, per te mundesuar perqatjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, te shkatuara nga mashtrimi apo gabimi.

Ne perqatjen e pasqyrave financiare, drejtimi eshte perqejges per vleresimin e aftesise se shoqerise per te vazduar ne vijimesi, duke dhene informacion, nese eshte e zbatueshme, per ceshtjet e lidhura me vijimesine dhe duke perdorur parimin kontabel te vijimesise, pavec se kur drejtimi synon te likujdoje shoqerine ose te nderprese aktivitetet, ose kur nuk ka alternatiqe tjeter reale pavec sa me siper.

Personat e ngarkuar me qeverisjen, jane perqejges per mbikeqyrjen e procesit te raportimit financiar te shoqerise.

Pergjegjesite e Audituesit per Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona jane qe te arrijme nje siguri te arsyeshme rreth faktit nese pasqyrat financiare ne teresi jane pa gabime materiale per shkak te mashtrimit ose gabimit dhe te leshojme nje raport auditimi qe perfshin opinionin tone. Siguria e arsyeshme, eshte nje siguri e nivelit te larte, por nuk eshte nje garanci qe nje auditim i kryer sipas SNA-ve, do te zbulloje gjithmone nje anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalite mund te vijne si rezultat i mashtrimit ose gabimit dhe konsiderohen materiale nese, individualisht ose te marra se bashku, pritet qe ne menyre te arsyshme te influencoje vendimet ekonomike te perdonuesve, te marra bazuar ne keto pasqyra financiare.

Nje pershkrim me i detajuar, i pergjegjesive te audituesit per auditimin e pasqyrave financiare, mund te gjendet ne faqen e internetit te IEKA-se ne : ieka.al. Ky pershkrim perben pjese te raportit tone te auditimit.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor
Rr. Perlat Rexhepi, Tirane, Shqiperi
Mars, 2018



Autoriteti i Avacionit Civil
 Pasqyra e Pozicionit Financiar ne 31 dhjetor 2017
 Moneda: Leke

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktivet afatshkurtra			
Mjetet monetare	4	151,115,453	156,441,385
Llogari te arketueshme tregetare	5.1	40,627,076	27,190,657
Llogari te arketueshme te tjera	5.2	1,052,670	1,537,810
Inventarë	6	1,941,733	2,762,424
Total aktive afatshkurtra		194,736,932	187,932,277
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	7	426,326,224	433,747,089
Total Aktiveve Afatgjata		426,326,224	433,747,089
Total Aktive		621,063,156	621,679,365
DETIRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregetare	8	5,921,377	52,173,833
Personeli dhe sigurime	9	2,249,308	7,226,606
Te ardhura te shtyra	10	18,028,800	20,000,000
Detyrime tatimore	11	3,899,323	2,857,871
Detyrime te tjera	12	978,296	-
Total Detyrime afatshkurtra		31,077,104	82,258,311
Detyrime afatgjata			
Grante	13	4,514,424	5,138,706
Provizione	16	1,214,841	1,214,841
Total Detyrime afatgjata		5,729,265	6,353,547
Totali i detyrimeve		35,820,769	88,611,858
Kapitalet e veta			
Kapitali		402,410,346	402,410,346
Fonde te mbartura		130,657,162	80,646,426
Fitimi i ushtrimit		51,189,279	50,010,736
Total kapitali aksionar		584,256,787	533,067,508
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		621,063,156	621,679,365

Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

Autoriteti i Avacionit Civil

Pasqyra e Performances ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

Shenime	Per vitin e mbyllur ne	
	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhura	15.1	352,320,146
Te ardhura te tjera	15.2	3,278,597
Materiale te para dhe te konsumueshme	16.1	(54,731,864)
Shpenzime te tjera	16.2	(32,713,832)
Shpenzime personeli	17	(205,547,826)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	7	(9,903,991)
<u>Shpenzime të tjera të shfrytëzimit</u>	<u>18</u>	<u>(1,513,450)</u>
Fitimi operativ		51,187,781
Zhvlerësimi i AF të mbajtura si aktive afatshkurtra	5.1	(750,000)
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto		1,498
Total shpenzime financiare		1,498
Fitimi para tatimit		51,189,279
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		
Fitimi i vtitit		51,189,279
Te ardhura te tjera te pergjithshme		
Totali i te ardhurave te pergjithshme		51,189,279
		50,010,736

Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

Autoriteti i Aviacionit Civil

Pasqyra e Fluksit te Parase per vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2017

Monedha: Leke

Shenime	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim/humbja e vitit	51,189,279	50,010,736
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7	9,903,991
Provizione		-
Humbje nga dalja jashtë perdorimit e AAM-ve		(12,246,399)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(12,951,278)	4,665,313
Ndryshimi ne inventar	820,691	371,479
Ndryshimi ne detyrimet per punonjesit	(4,977,298)	961,455
Ndryshimi ne llogari te pagueshme	(44,232,709)	47,036,161
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra	(1,971,200)	20,000,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(1,174,651)	119,980,799
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Blerje te aktiveve afatgjata materiale	(3,526,999)	(20,449,180)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(3,526,999)	(20,449,180)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Ndryshimi ne grante per investime	(624,282)	(693,352)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(624,282)	(693,352)
Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(5,325,932)	98,838,267
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	156,441,385	57,603,118
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	151,115,453
		156,441,385

Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

Autoriteti i Aviacionit Civil


Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017


Moneda: Leke


	Kapitali	Fonde te mbartura	Fitim Ushtrimit	Totali
<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>402,410,346</u>	<u>37,759,968</u>	<u>42,886,458</u>	<u>483,056,772</u>
Transferim në fondet e akumuluara Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:				
<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>402,410,346</u>	<u>42,886,458</u>	<u>(42,886,458)</u>	<u>0</u>
Transferim në fondet e akumuluara Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:				
<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>402,410,346</u>	<u>80,646,426</u>	<u>50,010,736</u>	<u>533,067,508</u>

Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

Pasqyrat financiare të Shqiqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 janë aprovuar nga drejtëtari i Autoritetit i Aviacionit Civil më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:


Kristën Keri
Drejtëtor Ekzekutiv




Feim Godo
Drejtëtor Ekonomik

Almira Gjergjaj
Specialiste Finance

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

1. Informacion i përgjithshëm

Autoriteti i Aviacionit Civil (më poshtë ‘Shoqëria’) është një institucion publik me vetë financim i krijuar me Ligi Nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar.

Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë është rregullimi dhe mbikqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 10 040 datë 22.12.2008 ‘Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë’.

Adresa e Autoritetit të Aviacionit Civil është Rr. Sulejman Delvina, nr.1, pranë Parkut të Delegacioneve, Tiranë dhe është rregjistruar me NIPT L01927451M.

1.1. Administrimi i Autoritetit të Aviacionit Civil

Organet drejtuese të Autoritetit të Aviacionit Civil janë këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv.

Këshilli drejtues është organ kolegjal, i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë, të cilët emërohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit, dhe është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Shoqërisë. Drejtori ekzekutiv është titullari i Shoqërisë, i cili emërohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministriti përgjegjës të transportit.

Struktura organizative dhe struktura e pagave të administratës së Shoqërisë miratohen me vendim të Ministrit, me propozimin e Këshillit Drejtues.

Më 31 Dhjetor 2017 Autoriteti i Aviacionit Civil kishte 85 punonjes (31 Dhjetor 2016: 89 punonjes).

1.2. Administrimi i Aeroportit të Kukësit

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 343, datë 7.6.2006 “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit” është vendosur si vijon:

- Aeroporti i Kukësit është pronë e paluajtshme e shtetit, me statusin e pronës së paluajtshme publike.
- Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil është organi përgjegjës për administrimin e këtij aeroporti.
- Sipas udhëzimit Nr. 2127/4 datë 7.07.2014 i Ministrisë së Transportit, dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së financave “Për administrimin e Aeroportit të Kukësit” deri në vënien në punë të Aeroportit të Kukësit, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të përballojë shpenzimet e administrimit të tij nga fondet e veta të programuara.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standarde Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

Zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 Janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

Ligji për agjensinë e Aviacionit civil, neni 17 përcakton se pasqyrat financiare të të ardhurave dhe shpenzime hartothen në përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Neni 19 i ketij ligji përcakton " Autoriteti mban regjistra kontabël në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Standardet Kontabël të Zbatueshme ".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe nëse ka te tilla.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimit dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rr Ethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë pëershruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e kryera ne monedhe te huaj janë konvertuar ne Leke me kursin e dites se kryerjes se transaksionit, ndersa gjendjet e llogarive te mjeteve dhe detyrimeve ne monedhe te huaj janë konvertuar ne Lek me kursin zyrtar ne diten e fundit te vitit te shpallur nga Banka e Shqiperise. Diferencat nga kurset e kembimit janë paraqitur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, ne llogarine perkatese për ndryshimet nga kursi i këmbimit, sipas SKK. Kursi i shpallur nga Banka Shqipërise ne 31 Dhjetor, sipas monedhave perkundrejt lekut:

Kursi i këmbimit	31.12.2017	31.12.2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiare

Instrumentat financiare jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiare jo-derivativë, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi të lidhet me to, përvç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njojjes fillestare instrumentat financiare jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finanziar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse, depozitat ne banka dhe fondet e vendosura si garanci.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provzionit llogaritet si diferençë midis vlerës së

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Vleresimi fillestar i elementeve qe plotesojne kriteret per njohjen si AAM behet me kosto blerje plus kosto të tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të shoqërise (përfshirë koston e prodhimit të aktivit). Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Normal vjetore të amortizimit të përdorura janë bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Normal e amortizimit dhe metoda e përdorur paraqitet ne tabelen e me poshteme:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz ne %		Metoda e llogaritjes
	2017	2016	
Vepra	1%	1%	Vlera Fillestare
Ndertesa e konstruksione	1%	1%	Vlera Fillestare
Inventar Ekonomik	3%	3%	Vlera Fillestare
Paisje Informatike	25%	25%	Vlera e mbetur
Makineri e Pasisje	5.8%	5.8%	Vlera Fillestare
Mjete Transporti	13.8%	13.8%	Vlera Fillestare
Studime e Kerkime	10%	10%	Vlera Fillestare

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Sipas ligjit për "Autoritetin e Aviacionit Civil" Nr. 10 233 datë 11.02.2010 neni 17 "Të ardhurat e Autoritetit", realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti në bazë të kostos. Ato përfshijnë:

- të ardhurat nga tarifat e rrugës (en-route), të cilat mblidhen dhe faturohen nga Eurokontrolli, në zbatim të marreveshjes së përbashkët të lidhur për tarifat e rrugës (en-route);
- të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, e cila merret nëpërmjet aeroportit;
- të ardhurat nga autorizimet, licensimet dhe certifikimet e parashikuara në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë;
- të ardhurat nga sanksionet në zbatim të legjislacionit në fuqi; dhe të ardhura të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

Autoriteti i Avacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Shoqërisë, si dhe për pagesat e kontributeve, që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të avacionit civil.

3.5. Buxheti

Ligji për "Autoritetin e Avacionit Civil" - Neni 18 percakton si më poshtë:

- Viti finanziar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor.
- Veprimitaria e Shoqërisë financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimitarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. Në vitet në vazhdim fondet e papërdorura derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

3.6. Fonde të papërdorura për shpenzime operative dhe investime kapitale

Autoriteti i Avacionit Civil, në bazë të pikës 4 të nenit 17 të ligjit "Për Autoritetin e Avacionit Civil" njësia ekonomike duhet t'i përdorë të ardhurat e saj me qëllim mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale. Sipas Autoritetit fondet e akumuluara të realizuara si diferençë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimet nga aktiviteti vjetor dhe të akumuluar deri në fund të periudhës ushtrimore, nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha investimet kapitale, si dhe nevojat për kapital punues të krijuara deri në këtë datë, për të garantuar një funksionin normal të Shoqërisë.

Në momentin e balancimit të nevojave të Shoqërisë për fonde për investimeve kapitale dhe për kapital punues, deri në atë masë që të garantojnë një funksionim normal të Autoritetit të Avacionit Civil, teprica e fondeve që do të krijohet do të derdhet në buxhetin e shtetit.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimitarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitimet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvèç diferençave të këmbimit që lidhen me veprimitaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Operacionet e qerave ne te cilat ka hyre shoqeria klasifikohen si qera operacionale

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesë mbi huamarrjet dhe humbjet ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Neni 17 i ligjit për “Autoritetin e Aviacionit Civil” pika 7 përcakton se Shoqëria është e përjashtuar nga të gjitha taksat dhe tatimet e drejtpërdrejta.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

Shoqëria ka planifikuar dhe realizuar edhe një fond me qëllim përfshirjen e personelit në skemën e pensionit privat suplementar referuar ligjit nr 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

3.12. Grantet për investime e shpenzime

Grantet për investime perbehen nga aktive afatgjata të marra nga institucionet shtetërore dhe private, pa pagesë dhe përfaqësojnë vlerën neto të tyre pas zbritjes së amortizimit të akumuluar. Një vlerë e njëjtë me amortizimin e vitit njihet edhe në të ardhurat e vitit në zërin “Të ardhura nga grante për aktive materiale të falura”. Grantet njihen si të ardhura në mënyrë sistematike gjatë periudhës kontabël, në të njëjtën mënyrë siç do të regjistrohen edhe shpenzimet që këto grante do të kompensojnë.

3.13. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen fluksete parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar fluksete përvetësime të ardhshme të parashë me një normë skontimi që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parashë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren ne te ardhura.

3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

4. Mjete monetare

Mjetet monetare ne bankat tregtare më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari rrjedhese ne leke	2,557,628	14,820,217
Llogari rrjedhese ne Euro	94,744,135	111,139,740
Llogari rrjedhese ne USD	180,591	481,428
Llogari garancie (escrow)	27,043,100	30,000,000
Mjete monetare në tranzit	26,590,000	
	151,115,453	156,441,385

Ne llogarine e garancisë, paraqiten fondet e mbetur per projektin “Realizimi i studimit të fizibilitetit per ndertimin e nje aeroporti ne jug te vendit”. Fondet e projektit me vlerë 30 milione leke jane vendosur ne vitin 2016, sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr 564, date 29.07.2016. Ky projekt eshte financuar nga Albcontrol sha dhe Shoqeria.

Mjete monetare ne tranzit paraqesin fondet e transferuara midis llogarive të Shoqerise. Fondet e transferuara nga llogaria ne Banken Kombëtare Tregtare ne date 28/12/2017; kane hyre ne llogarine prane Union Bank, ne date 03/01/2018.

5. Llogari të arkëtueshme

Ne daten 31 Dhjetor 2017, kerkesat e shoqerise ndaj klienteve dhe të tjera janë ne shumën 41,680 mijë leke. (2016; 28,728 mijë leke)

5.1. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Anta	13,500,000	14,000,000
TIA	27,055,192	13,143,139
Belle Air	8,142,500	8,142,500
Shega Air	750,000	750,000
Te tjere	71,884	47,518
Zhvleresim kerkesave per arketim	(8,892,500)	(8,892,500)
	40,627,076	27,190,657

Zhvleresimi i kerkesave per arketim lidhet me provisionet e njohura ne masen 100% per llogarite e arkëtueshme nga Belle Air dhe Shega Air.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

5.2. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arketueshme më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paradhenie Personeli	-	1,123,170
Kerkesa ndaj personelit	1,025,273	387,243
Kerkesa furnitore	27,397	27,397
	<u>1,052,670</u>	<u>1,537,810</u>

6. Inventari

Balanca e inventarit, sipas zerave më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kanceleri	330,851	645,200
Tollona Karburant	1,412,882	1,599,064
Pjesë ndërrimi	-	320,160
Inventare te tjera	198,000	198,000
	<u>1,941,733</u>	<u>2,762,424</u>

7. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Toka	Ndertesa	Mobilje e paisje zyre	Paisje informatike	Mjete transporti	Te tjera AAM	Ne proces	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	292,160,180	100,623,997	10,591,352	29,457,386	22,563,817	4,771,439	8,840,400	469,008,572
Shtesa				12,289,399		78,000		12,367,399
Pakesime			(491,080)	(2,544,218)		(45,040)	(8,840,400)	(11,920,738)
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	292,160,180	100,623,997	10,100,272	39,202,567	22,563,817	4,804,399	-	469,455,232
Zhvlerësimi i akumuluar								
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	7,013,808		2,762,792	13,771,545	9,594,937	2,118,400		
Amortizimi i vitit	1,006,240		368,472	4,170,352	3,062,150	1,296,777		35,261,482
Pakesime			(100,878)	(1,900,562)		(35,025)		9,903,991
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	8,020,048		3,030,386	16,041,335	12,657,086	3,380,152	(2,036,465)	
Vlera kontabel neto								43,129,007
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	292,160,180	93,610,189	7,828,560	15,685,841	12,968,880	2,653,040	8,840,400	433,747,090
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	292,160,180	92,603,949	7,069,886	23,161,232	9,906,731	1,424,248	-	426,326,225

Autoriteti i Avacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitore	4,713,644	41,295,237
Fatura te pamberitura	1,207,734	10,878,596
	5,921,377	52,173,833

9. Personeli dhe Sigurimet

Detyrimet ndaj personelit dhe detyrimet per sigurime shoqerore dhe shëndetsore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Personeli	24,446	5,496,780
Sigurime Shoq & Shendetsore	2,224,862	1,729,826
	2,249,308	7,226,606

10. Te ardhura te shtyra

Ne kete post paraqitet vlera e kaluar nga Albcontrol sha, per financimin e projektit “Realizimi i studimit të fizibilitetit per ndërtimin e nje aeroporti ne jug te vendit” Ne vitin 2017, vlera prej 1,971,200 leke ka kaluar ne te ardhurat e periudhes, per mbulimin e pjesshem me fondet e Albcontrol te shpenzimeve te studimit te fizibilitetit te lidhur me kete projekt.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Albcontrol	18,028,800	20,000,000
	18,028,800	20,000,000

11. Detyrime Tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim mbi te ardhurat personale	3,418,992	503,089
Tatim ne burim	480,330	2,354,782
	3,899,323	2,857,871

12. Detyrime te Tjera

Ne kete post paraqitet detyrimi i Shoqerise per demshperblimin e nje punonjesi te larguar sipas vendimit te Gjykates se Apelit Administrativ Tirane.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

13. Grante

Balanca e granteve dhe lëvizja përgjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Balanca e mbartur	5,138,706	5,832,058
Shtesa gjate vitit	683,115	653,700
Pakesime	(1,307,397)	(1,347,052)
Balanca ne fund te periudhes	4,514,424	5,138,706

14. Provizonet

Balancat dhe lëvizjet në provizione për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqitet si mëposhtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Balanca e mbartur	1,214,841	13,461,240
Shtese shpenzime	-	1,214,841
Pagesa te kryera	-	(920,020)
Rimarrje te ardhura	-	(12,541,220)
Balanca ne fund te periudhes	1,214,841	1,214,841

Nuk ka ndryshime ne kete post per vitin 2017. Provizioni prej 1,215 mijë leke i mbartur nga viti 2016, lidhet me procesin gjyqjesor ende ne proces me shoqerine Vodafone Albania sha.

15. Të ardhurat**15.1. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 detajohen si me poshte:

	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
Te ardhura nga mbikalimet	162,000,000	162,000,000
Te ardhura nga tarifat e sigurise	178,404,585	151,305,645
Te ardhura te tjera	10,797,500	31,190,244
	352,320,146	344,495,889

Autoriteti i Avacionit Civil

Shenimet shpjeguese të pasqyrave finaciare për vitin ushtrimor të mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

15.2. Të ardhurat e tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 detajohen si me poshtë:

	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
Grante	1,307,397	1,347,052
Te tjera	<u>1,971,200</u>	-
	<u>3,278,597</u>	<u>1,347,052</u>

Te tjera paraqet vleren e fondeve të Albcontrol te perdorura, per mbulimin e pjesshem te shpenzimeve te kryera per projektin e studimit te fizibilitetit. Vlera totale e shpenzimit per raportin fillestar te studimit te fizibilitetit eshte 2,956,800 leke dhe paraqitet ne zerin shpenzime te tjera (shenimi 16.2)

16. Shpenzime nga aktiviteti i shfrytezimit**16.1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016:

	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
Utilitarë	3,192,702	3,317,011
Karburant	2,626,962	3,584,357
Mirembajtje	595,386	1,920,136
Kanceleri e te tjera te konsumueshme	3,067,586	5,222,434
Roje objekti	20,660,872	20,081,067
Udhetime & Dieta	14,387,113	29,200,246
Kuota antaresimi	10,201,244	10,638,433
Prime sigurim ndertese	-	2,940,000
Regjistrim prone	-	195,200
	<u>54,731,864</u>	<u>77,098,885</u>

Autoriteti i Aviacionit Civil

Shenimet shpjeguese të pasqyrave finaciare për vitin ushtrimor të mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

16.2. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
Qira	959,941	4,105,838
Perkthime & noterizime	611,900	484,000
Shpenzime fizibiliteti	2,956,800	-
Rindertim & mirembajtje webpage	462,000	-
Mirembajtje database	645,000	-
Mirembajtje programi Alpha	108,000	108,000
Mirembajtje zyre	254,400	1,009,200
Sherbime & Konsulenca	1,080,000	1,022,562
Shperblime keshilli drejtues	1,517,850	1,897,400
Abonime & Reklama	1,522,238	42,505,644
Komunikimi	2,658,475	3,602,416
Mirembajtje automjete	290,739	865,569
Siguracion automjete	666,400	790,000
Komisione banke	284,237	117,145
Taksa dhe tarifa vendore dhe automjete	58,139	95,423
Trajnime dhe seminare	10,157,964	11,212,890
Shpenzime pritje, përcjellje	1,550,597	3,009,315
Shpenzime te tjera administrimi	3,988,691	2,185,188
Humbje nga kembimet valutore	1,713,688	1,943,579
Vlera kontabel e AAM-ve jashte perdonimit dhe te transferuara	1,043,873	37,125
Shpenzime te tjera	182,900	250,400
	32,713,832	75,241,695

17. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016:

	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
Shpenzime per paga	152,058,576	81,057,839
Shpenzime per sigurime shoq e shend	17,756,525	11,981,100
Shperblime	20,471,428	23,960,271
Skema pensioni private	15,261,297	15,259,932
	205,547,826	132,259,142

Autoriteti i Avacionit Civil

Shenimet shpjeguese te pasqyrave finaciare per vitin ushtrimor te mbyllur ne 31 dhjetor 2017
Monedha: Leke

18. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat, penalite dhe provisionin e njoitura per procese gjyqesore te hapura.

	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2016
Gjoba dhe dëmshpërblime	1,513,450	123,171
Provizione per vendime gjygesore	—	1,214,841
	1,513,450	1,338,012

19. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.